

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME SPECIALIZIM
NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



TEZA MASTER

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Sylejman Berisha

Kandidati/ja:

Natyra Berisha

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME SPECIALIZIM
NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



TEZA MASTER

Shfrytëzimi i teknologjisë dhe perceptimet e mësimdhënësve
për nxënës me nevoja të veçanta

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Sylejman Berisha

Kandidati/ja:

Natyra Berisha

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

FALENDERIM	v
DEKLARATA E ORIGJINALITETIT	VI
ABSTRAKTI	1
ABSTRACT (ENG)	2
<u>KAPITULLI I</u>	<u>3</u>
1.1. HYRJE	3
1.1.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT	4
1.1.2. PYETJET E HULUMTIMIT	5
1.1.3. HIPOTEZA E HULUMTIMIT	6
<u>KAPITULLI II</u>	<u>8</u>
2.1. PËRKUFIZIMI I PUNËS SË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE ARSIMORE	8
2.1.1. IMPLIKIMET PËR PËRGJIGJET GJITHËPËRFSHIRËSE	9
2.1.2. DEFICITET E NDJENJAVE <i>MAGNOCELULARE</i>	10
2.1.3. DEFICITI I PËRPUNIMI I INFORMACIONIT VIZUAL	11
2.1.4. HAPAT LEHTËSUES PËR TRAJTIMIN E PROCEDIM EDUKATIVO-ARSIMORË ME NXËNËS ME NEVOJA TË VEÇANTA	12
2.2. ZHVILLIMET E FUNDIT DHE QASJA NË PLATFORMAT INTELIGJENTE	14
2.3. MOTIVIMI PËR MËSIMDHËNËSIN	15
2.3.1. MOTIVIMI SI SHTYTJE	16
2.3.2. FAKTORËT QË KONTRIBUOJNË NË NIVELIN E PRANIMIT TË TEKNOLOGJISË NË INSTITUCIONET EDUKATIVO-ARSIMORE	18
2.3.3. NJOHJA E FUSHËVEPRIMIT TË ARSIMIT PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA	18
2.3.4. NDRYSHIMET E IMPONUARA	19
2.3.5. Qëllimi prapa IDEA-së është:	19
2.3.6. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIMIN SPECIAL: ZBATIMI DHE ZGJIDHJET	21
2.3.7. SI TEKNOLOGJIA THJESHTON PROCESIN ARSIMOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.	21
2.3.8. THYERJA E BARRIERAVE ME ZBATIMI E TI NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMORË	23

2.3.9. SHEMBUJ TË BAZUAR NË FAQE TË NDRYSHME PËR ZGJIDHE TË EDUKIMIT SPECIAL	23
2.3.10. VLERËSIMET DHE MATJA E ARRITSHMËRISË	24
KAPITULLI III	26
3.1. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	26
3.1.1. METODAT E HULUMTIMIT	26
3.1.2. POPULACIONI DHE MOSTRA	27
3.2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	27
3.3. METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT	28
3.4. DEFINIMI I PROBLEMIT, QËLLIMI I HULUMTIMIT, PYETJET DHE HIPOTEZA E HULUMTIMIT	29
KAPITULLI IV	30
4.1. REZULTATET E ARRITURA TË HULUMTIMIT	30
4.2. ANALIZA E REZULTATEVE	33
4.2.1. PARAQITJA E REZULTATEVE NGA PYETËSORI	33
4.2.2. PËRFSHIRJA E TEKNOLOGJISË NË EDUKIM SPECIAL	53
KAPITULLI V	66
5.1. PËRFUNDIME	66
5.2. REKOMANDIMET	69
5.3. HULUMTIMET E MËTUTJESHME	70
5.2. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE	72
ANEX 1	74
LISTA E TABELAVE	
Tabela 1 Lloji dhe kurset mbajtura nga respondentët	36
Tabela 2 Testi model me më shumë se një të dhënë nga përgjigjet e grumbulluar mbi kurset e ndjekura	37
Tabela 3 Roli i respondentëve në institucion	39
Tabela 4 Ku punoni me nxënës me nevoja të veçanta	40
Tabela 5 cila është aftësia (kyçe) e kufizuar e nxënësve me të cilët jeni apo keni punuar?.....	42

Tabela 6 devijimi standart në pjesëmarrjen e përgjigjeve nga pyetje 12 e pyetësorit .	43
Tabela 7 Përshinë e programe në përputhje me objektiven e institucionit ku jeni i angazhuar	44
Tabela 8 Trajtimi special në procesin e rregullt të mësimit klasorë	47
Tabela 9 pjesëmarrja në përgjigje dhe devijimi standard	48
Tabela 10 Shfrytëzimi i praktikave dhe metodave	49
Tabela 11 Procesimi i velerësimeve mbi suksesin e programit	51
Tabela 12 Shpërndarja e përgjigjeve sipas torisë Bayesian VLTh	52
Tabela 13 Ngritja e ndihmës me TI për fëmijët me nevoja të veçanta	53
Tabela 14 Lidhshmëria mes alternativave sipas versionit P-P Plot	54
Tabela 15 rezultatet e qëndrueshmërisë	56
Tabela 16 Lidhshmëria mes alternativave - pyetja 21	56
Tabela 17 Përmbledhja statistikore rezultatet e pyetjes 21	57
Tabela 18 Përshkallëzimi i rezultateve dhe devijimi standard.....	57
Tabela 19 Përshkrimi statistikorë mes alternativave nga pyetja #22.....	58
Tabela 20 Paraqitja numerike e rezultateve për secilën alternativë.....	59
Tabela 21 Lidhshmëria e rezultateve të peshuara nga pyetja 20 alternativa 2 me alternativat e pyetjes 22	60
Tabela 22 Procesimi i përgjigjeve nga pyetja 23 me gjatësi serike	62
Tabela 23 Perceptimi individual në ballafaqim me trajtimin e mësimit me nxënës me nevoja të veçanta.....	63
Tabela 24 Statistikat përshkruese të niveleve të faktorëve brenda subjektit	64

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Ilustrim i nxënësës me karrocë për lëvizje në ambientë shkollorë (marrë nga interneti).....	30
Figura 2 dallimet e nxënësve me nevoja të veçanta.....	32
Figura 3 Ndarja sipas gjinisë së respondentëve	33

Figura 4 pasqyra e përvojës vjeçare e respondentëve pjesëmarrës	34
Figura 5 numri i stafit edukativo-arsimorë që punon me nxënës me aftësi të kufizuara	35
Figura 6 Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në klasë	41
Figura 7 pajisja me kompjuter e nxënësve me nevoja të veçanta	50
Figura 8 Lidhshmëria e përzgjedhjeve sipas metodës P-P Plot	55

FALENDERIM

Ky punim është realizuar falë Zotit i cili më mundësoi shëndetin, suksesin si dhe vetëbesimin me të cilën mund të arrijë gjithçka në jetë. Një falënderim dhe mirënjohje shkon për familjen time, për kurajën dhe mbështetjen që më kanë ofruar gjithmonë në rrugën e gjatë të arsimimit, ku në sajë të tyre gjeta mbështetjen e duhur të cilët më dhanë gjithë përkrahjen që unë të filloj dhe t'i mbarojë studimet Master. Një falënderim shkon për profesorin e nderuar Prof.Asoc.Dr. Sylejman Berisha për mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës sime në finalizimin e këtij punimi të diplomës, me këshillat, konsultimet dhe rekomandimet e tij. I nderuari Profesori Sylejman Berisha me përkushtimin, dijen, kulturën gjithnjë më ka rritur besimin tek vetja në përballjen me sfidën e madhe që kam patur përpara. Këshillat e tij metodike dhe profesionale kanë qënë të domosdoshme, ndërsa mbështetja e tij morale më ka inkurajuar në mënyrë të vazhdueshme. Falënderim i tillë po ashtu edhe për profesorët tjerë të cilët na ndihmuan në vazhdimin e rrugëtimit tonë gjatë studimeve. Dëshiroj të falënderoj gjithashtu UP, i cili na mundësoi që studimet të përfundojmë në hapësirat e fakultetit të edukimit si dhe mundësinë që të jemi ekip i studimeve së bashku me profesorët dhe studentët. Falënderime të veçanta ju shpreh shoqërisë time dhe kolegëve të fakultetit për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë dhe aftësim të cilin e kemi ndarë së bashku. Po ashtu falënderime të përzemërta për bashkëpunëtorët të cilët punova gjatë fillimit të karrierës sime të cilët besuan punën time dhe të cilët më mundësuan punë të vazhdueshme.

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Ky punim Diplome është puna ime (punim grupor) origjinale dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë grade në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Dhe nuk përmban, sipas njohurisë time, asnjë material të botuar ose shkruar nga një person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

STATEMENT OF ORIGINALITY

This thesis is my (our groups) original work and has not been submitted, in whole or in part, for a degree at this or any other university. Nor does it contain, to the best of my knowledge and belief, any material published or written by another person, except as acknowledged in the text.

Emri/Name

Nënshkrimi/Signaure

Data/Date

Natyra Berisha

ABSTRAKTI

Teknologjitë më të avancuara janë ato që zhduken nën strukturën e jetës së përditshme, derisa prezenca e tyre nuk dallohet fare. Konsideroni shkrimin, mbase teknologjia e parë e informacionit, aftësia për të shfaqur gjuhën e të folurit në mënyrë simbolike për ruajtje afatgjatë të liruar nga kufijtë e kujtesës individuale. Sot kjo teknologji është e gjithandej, e qasshme pothuajse kudo në botë, teknologji diskrete dhe pjesë integrale e jetës (Weiser, 1991).

Përmes këtij punimi kuptohen perceptimet, përvoja dhe rëndësia e mësimdhënësve që kanë dhe mendojnë ta zhvillojnë në konceptin e shfrytëzimit të teknologjisë në proceset edukativo-arsimore me theks të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta. Ky punim, sigurisht që është “një pjesë” e një projekti më të madh që me zhvillimin e materialeve mësimore për nxënësit, posaçërisht për kategorinë e atyre me nevoja të veçanta, mësimdhënësit e tyre dhe prindërit përforcon qëndrimin për zhvillim. Analiza e nevojave të tilla janë bërë për të kuptuar situatën aktuale. Të dhënat që janë grumbulluar duke përdorur pyetësorë, intervista gjysmë të strukturuar dhe duke analizuar dhe përdorur qasjen e analizës së përmbajtjes, japin rezultatet që tregojnë se përdorimi i teknologjisë për qëllime mësimore është i kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe materialeve të duhura.

Mësimdhënësit besojnë se përdorimi i teknologjisë në klasë përmirëson cilësinë e rezultateve arsimore dhe kënaqësinë e punës. Në lidhje me të mësuarit e teknologjive të reja për përdorim arsimor, mësimdhënësit nuk e ndiejnë detyrimin të mësojnë teknologji të reja nëse nuk bëhet e domosdoshme. Për më tepër, ekziston një potencial i madh për të zhvilluar materiale në fushën e arsimit special me teknologji të reja. Së bashku me krijimin e materialeve për nxënësit që përdorin zbulimin e lëvizjes trupore, ekranin me prekje dhe teknologjitë e lodrave të zgjuara, është gjithashtu e nevojshme të aftësohen mësimdhënësit se si t'i përdorin ato në klasë dhe t'i trajnojnë prindërit për të vazhduar procesin me nxënësit me nevoja të veçanta po ashtu në shtëpi. Materialet mund të mbështesin mësuesit gjatë mësimit të aftësive dhe vetë-kujdesit, aftësive shoqërore dhe koncepteve njohëse. Për më tepër, ndihmojnë nxënësit të forcojnë dhe transferojnë këto aftësi dhe njohuri në kontekste të reja, duke siguruar shumë praktika-reagimesh (*feedback*) dhe shumëllojshmëri të konteksteve reale.

Fjalë kyçe: TIK, integrimi; mësimdhënie; speciale, kërkesa të veçanta, arsimim, edukim.

Abstract (Eng)

The most advanced technologies are those that disappear under the structure of daily life, until their presence is not discernible at all. Consider writing, perhaps the first information technology, the ability to display spoken language symbolically for long-term storage freed from the limits of individual memory. Today this technology is ubiquitous, accessible almost anywhere in the world, discrete technology and an integral part of life (Weiser, 1991).

Through this paper will understand the perceptions, experience and importance of teachers who have and intend to develop them in the concept of using technology in educational processes for pupils with special needs. This paper is certainly part of a larger project that as such aims to develop teaching materials for pupils, especially for the category of those with special needs, teachers and their parents, and as such aims to provide academy contribution in general. The analysis of such needs is done to understand the current situation. Data that was collected using questionnaires, semi-structured interviews, and analyzing and using the content analysis approach, providing results that show that the use of technology for teaching purposes is limited due to the lack of appropriate infrastructure and materials.

Teachers believe that the use of technology in the classroom improves the quality of educational outcomes and job satisfaction. With regard to learning new technologies for educational use, teachers do not feel compelled to learn new technologies unless it becomes necessary. Moreover, there is a great potential to develop materials in the field of special education with new technologies. Along with creating materials for students that use body movement detection, touch screen, and smart toy technologies, it is also necessary to train teachers on how to use them in the classroom and to train parents to continue process with students with special needs also at home. The materials can support teachers in teaching skills and self-care, social skills and cognitive concepts. Furthermore, they help students reinforce and transfer these skills and knowledge to new contexts by providing a variety of feedback practices and a variety of real-world contexts.

Keywords: ICT, integration; teaching; special, special needs, education.

KAPITULLI I

1.1. HYRJE

Një nga aspektet më të rëndësishme të teknologjisë në arsim është aftësia e tij për të niveluar fushën e mundësive për studentët.

John King, Sekretari Amerikan i Edukimit

Teknologjia është një mjet i fuqishëm për transformimin e të mësuarit. Mund të ndihmojë në afirmimin dhe avancimin e marrëdhënieve midis mësimeve dhe nxënësve, të rikrijojë qasjet tona për të mësuar dhe bashkëpunuar, të zvogëlojë boshllëqet afatgjate dhe ngritë mundësinë e arritjes dhe të adaptojë përvojat e të mësuarit për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve, posaçërisht për kategorinë e procesit për edukim special.

Shkollat, kolegjet e shoqëria, qendrat e të mësuarit për të rritur dhe universitetet duhet të jenë inkubatorë të kërkimit dhe shpikjes. Mësimeve duhet të jenë bashkëpunëtorë në të mësuar, të kërkojnë njohuri të reja dhe përvetësojnë vazhdimisht aftësi të reja së bashku me nxënësit e tyre. Administratorët e arsimit duhet të krijojnë një vizion për krijimin e përvojave të të nxënësve që ofrojnë mjetet e duhura dhe mbështetje për të gjithë nxënësit që ata të lulëzojnë.

Integrimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ndihmon mësimeve që t'i bashkohen me kërkesën globale për të zëvendësuar procese dhe metodat tradicionale të mësimit dhe për ta përforcuar atë me mjete mësimore të bazuara në teknologji. Në shumë vende, TIK konsiderohet si një nga elementët kryesorë në shndërrimin e vendit në zhvillimin e ardhshëm.

Situata aktuale me paraqitjen e pandemisë me COVID-19, tregoj bindshëm që mundësia për të shfrytëzuar teknologjinë informative (TI) është e mundur dhe për më tepër është e mirëseardhur. Padyshim që format e qasjes, platformat që aktualisht po shfrytëzohen duhet të analizohen thellësisht, transformimi i procesit edukativo-arsimor është duke kaluar ndryshimet më të mëdha përgjatë historisë, se që janë parë deri në fillimin e vitit 2020.

Me këtë punim synohet të analizohen perceptimet e mësimeve për efektivitetin e integritet të TIK-ut për të mbështetur procesin mësimor special dhe përfshirjen e nxënësve me kërkesa të veçanta.

Shekullin XXI, termi "teknologji" është bërë çështje e rëndësishme në shumë fusha, përfshirë arsimin. Kjo për shkak se teknologjia është bërë autostradë e transferimit të njohurive në shumicën e vendeve dhe fushave. Integrimi i teknologjisë në ditët e sotme ka kaluar përmes inovacioneve dhe ka shndërruar shoqëritë tona që ka ndryshuar plotësisht mënyrën se si njerëzit mendojnë, punojnë dhe jetojnë (Mark Grabe, 2007). Si pjesë e kësaj, institucionet arsimore të të gjitha niveleve supozohen të duhet të përgatisin nxënësit për të jetuar në një "shoqëri me dije" dhe duhet të marrin parasysh integrimin e TIK-ut proceset edukativo-arsimorë (Ghavifekr, Afshari, & Salleh, 2012).

Përveç zhvillimet drejt integrit të TIK-ut në procesin edukativo-arsimorë, mbetet shqyrtimi i mënyrës së drejt në aspektin vlefshmërisë dhe arritjeve tek kategoritë e nxënësve me kërkesa të veçanta. Duke nënvizuar rëndësinë e vlefshmërisë dhe pasojave eventuale mbi vlerësimin e arritjeve të mësimnxënies dhe transferit të dijës, duhet të ushtrohet kujdes dhe mbështetje teorike për lëvizjen e integrit të TIK-ut dhe vlerësimin si parim i përgjithshëm. Problemi për studiuesit e vlefshmërisë është gjetja e grupit të duhur të kriterëve dhe standardeve për të mbështetur njëkohësisht vlefshmërinë e një interpretimi të bazuar në vlerësim dhe vlefshmërinë e ndikimit të tij në sistemin arsimor.

Pavarësisht vëmendjes së shtuar për procesin edukativo-arsimorë nga konferencat dhe botimet shkencore, ende nuk është gjete një konsensus i përbashkët për të mësuarit special me integrimin e teknologjive në procese të ndryshme. Më saktësisht, nuk ka as një konsensus për vetë termin. Ekzistojnë më pak a shumë terme të ndryshme për të ngjashmërinë sinonime si mësimi pa tela, i kudogjendur, nga distanca, virtuale etj., që parimisht i referohen mësimin elektronik apo siç po njihet me termet e përgjithshme (*e-Learning, m-Learning, u-Learning...*). Situata të tilla si gjendja e paqartësisë krijuese të termave dhe koncepteve janë tipike për një disiplinë në zhvillim, e ky zhvillim pritet që të transformoj procesin edukativo-arsimorë në vazhdimësi, së paku deri sa të përcaktohet qëndrueshmëri në një nga format e aplikimit të saj.

1.1.1. Qëllimi i hulumtimit

Fillimi i vitit 2020, me paraqitjen e situatës me pandeminë COVID-19 e cila përveç që paralizoj botën në pothuajse të gjitha fushat e jetës moderne, sfidoj në masë të madhe procesin e shërbimit mbi kujdesin e shëndetit dhe me një shpejtësi marramendësi transformoj procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mbarë globin. Bota ndryshoj për më pak se

tre muaj, dhe dyshohet që nuk do të mund t'i kthehet 'normalitetit' siç po i referohet shoqëria sot gjendjes që kishim deri në nëntorin e vitit 2019. Procesi edukativo-arsimorë për nxënësit me nevoja të veçanta tani është më i brishtë se kurrë.

Ky ndryshim global, që u përcjell - dhe vazhdon tutje - me dyshime të shumta, preku në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin mësimorë duke kaluar plotësisht nga mësimi tradicional në atë virtual - nga distanca. Natyrisht ky proces vë në dyshim aftësitë e fuqive shtetërore për mbështetjen praktike dhe njohurive institucionale për të u përballur me këtë ndryshim me transferim aq të shpejt nga tradicionalja në diçka ende krejtësisht jo të qartë, dhe padyshim sfidon aftësinë familjare dhe të shoqërisë për ti dalë në ndihme kategorive të veçanta.

Padyshim, ka institucione që ndryshimin e mësimin tradicional e kishin në plan dhe pjesërisht edhe të zbatueshme, dhe për atë kategori të institucioneve ishte paksa më i lehtë ky ndryshim. Universiteti i mirënjohur Cambridge (Shead, 2020) është deklaruar që viti akademik 2020/21 do ta zhvilloj tërësisht nga distanca, dhe që vetëm një pjesë e studentëve në grupe të vogla mund të zhvillojnë aktivitet e tyre në objektet e institucionit. Bota po ndryshon.

Punimi analizon aftësinë mësimdhënëse dhe mat perceptimit e tyre për shfrytëzimin e TIK në përgjithësi dhe aplikimin e ndryshimeve nga procesi i të mësuarit tradicional në diçka të re, inovative dhe vlerëson gatishmërinë e involvimit me këtë ndryshim për kategoritë e nxënësve me nevoja të veçanta.

Marrë parasysh që procesi i mësimnxënies nuk është identik për të gjitha qeniet njerëzore, dhe që mësimdhënësit po hyjnë në situata të të mësuarit me një stil ndryshe, ky ndryshim, krijon mundësi dhe njëkohësisht sfidë. Lidhur me këtë ndryshim të të mësuarit ekziston një teori për mënyrën sesi njerëzit mësojnë, ose më saktë, se si ata vetë mësojnë më mirë. Ambientet e të mësuarit që funksionojnë sipas një teorie që nuk është i ngjashëm me stilin e preferuar të të mësuarit të një personi, ndodh të refuzohet ose të has në rezistencë. Kuptim i mjediseve të mësimnxënies është i rëndësishëm për mjediset arsimore të bazuara në platforma multimediale dhe internet.

1.1.2. Pyetjet e hulumtimit

Orientimi i punimit është i fokusuar tek perceptimi i mësimdhënësit, aftësive individuale dhe institucionale për shfrytëzimin e teknologjive të ndryshme informative dhe ndryshimet që TIK-u sjell në këtë proces. Është e rëndësishme që jo vetëm mësimdhënësit të akomodohen me ndryshimet e imponuara - posaçërisht pas COVID-19 - dhe mësim nga

distanca. Marrë parasysh që perceptimet e mësimit ndryshojnë gjatë shfrytëzimit të TIK-ut në procesin mësimorë, si për trajtimin e materies të bazuar me kurrikulës, ashtu edhe për format e ndryshme të imponuara dhe angazhimin e personelit jo-mësimorë (profesionistët e TIK-ut) si pjesë integrale e sistemit. Për më tepër, vlerësimi mbetet sfidë e veçantë, marrë parasysh aftësitë individuale të nxënësit me nevoja të veçanta për të paraqitur përgjigje nga burime të ndryshme pa i fituar njohuritë e mjaftueshme.

Pyetjet që tentohet përmes këtij punimi t'i përgjigjemi janë:

1. Sa janë të gatshëm mësimit të zëvendësojnë procesin tradicional edukativo-arsimorë me inovacionet që imponohen nga TIK? dhe
2. Çfarë nevojitet të bëjnë institucionet që të adaptohet platforma e mësimit me TIK në Kosovë?

1.1.3. Hipoteza e hulumtimit

Shumica e adaptimeve që i ka imponuar TIK-u në jetën e përditshme - posaçërisht në dy dekadat e fundit - janë përfshirë edhe në procesin edukativo-arsimorë, në raste specifike edhe pa ndonjë plan - rrjedhimisht duke iu përshtat rrethanave të reja. Megjithatë, ka të tilla procese që rrallë ose kurrë nuk përdoren nga mësimit. p.sh. ndërtimi i grupeve virtuale punuese, aktivitete në nivele të ndryshme të vështirësisë, shfrytëzim të burimeve specifike me TIK, etj.

Ajo që vërehet me theks më të veçantë e që përsëritet, ishte se të gjithë mësimit kufizohen fuqimisht nga ritmi, programi kurrikulës dhe zbatimi në përpikshmëri i librit shkollor me qenë se kategoritë me kërkesa speciale kërkojnë adaptim në zhvillimet e ndryshimeve.

Mungesa e kohës dhe programet e mbingarkuara janë raportuar si disa nga pengesat kryesore që ndalojnë zbatimin e përshtatjeve. Për më tepër, fusha akademike duket që ndikon në modelin e përgjigjeve të mësimit derisa një numër i koncepteve të gabuara dalin në pah, dhe natyrshëm marrin mirëkuptimin e mësimit duke u bazuar në njohuritë e përshtatjeve të veçanta. Implikimet në lidhje me trajnimin e mësimit, përgjigjet gjithëpërfshirëse dhe praktikave diskutohen dhe analizohen në vazhdimësi.

h0 - Mësimi për mësimit dhe shfrytëzimi i TIK-ut për ndërtimin e procesit që do ta kombinonte mësimin tradicional dhe atë inovative me përfshirjen e TIK-ut në shkollat kosovare, është proces i pakthyeshëm dhe sfidohet nga kërkesat speciale.

h1 - Niveli i ndryshimeve në procesin edukativo-arsimorë imponohet nga gatishmëria institucionale, aftësia individuale e nxënësit me nevoja të veçanta dhe e mësimdhënësit për të ndryshuar.

h2 - perceptimin i arritshmërisë së ndërtimit të një sistemi të ri, adekuat, të lehtë për shfrytëzim, krijon vetëbesim dhe pavarësi të plotë akademike.

KAPITULLI II

2.1. PËRKUFIZIMI I PUNËS SË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE ARSIMORE

Është e rëndësishme të përcaktohet termi "teknologji arsimore", pasi që është përdorur gjerësisht në literatura të shumta që trajtojnë çështje të ndjeshme, posaçërisht kur bëhet fjalë për nxënës me nevoja të veçanta. Këtu, teknologjia arsimore përcaktohet si një larmi mjetesh dhe aplikacionesh elektronike që ndihmojnë në shpërndarjen e përmbajtjes mësimore dhe mbështesin procesin e të mësuarit, në këtë rast për nxënësit me nevoja të veçanta. Në shumë tekste, punime shkencore dhe të tjera shembujt përfshijnë udhëzime se si mund të ndihmohemi nga kompjuteri, dhe si sisteme të integruara të të mësuarit dhe përdorimi i videos ose formave të tjera mediatike ndikojnë në “ngulitje” si përbërës të udhëzimit për të lexuar dhe për t’u aftësuar.

Që të kufizohet arsyetimi dhe metoda e ndërtimit të këtij punimi, janë identifikuar disa lloje kryesore të aplikacioneve të teknologjisë arsimore: udhëzime tradicionale si mjete shtesë të ndihmuara nga kompjuteri, modele gjithëpërfshirëse, programe plotësuese të integruara në grupe të vogla siç janë *Fast ForWord (FFW)* - një qasje e veçantë që thekson mësimin e diskriminimeve dëgjimore -, programet plotësuese, të tilla të destinuara për lexim siç janë *Plato Focus*, *Waterford* e *WICAT*, me anë të të cilave ofrohen udhëzime shtesë për nxënësit e vlerësuar në nivelet e nevojës për të plotësuar udhëzimet e të mësuarit tradicional në klasë. Modelet gjithëpërfshirëse që përdorin udhëzime të ndihmuara nga kompjuteri së bashku me aktivitete jo kompjuterike si qasja thelbësore e leximit dhe detyrave të tjera edukativo-arsimore. Modele të integruara për grupe të vogla siç janë leximi dhe shkrimi dhe programet për renditje specifike, janë aplikacione teknike arsimore të teknologjisë që përdorin ndërveprimin e grupeve të vegjël të integruara ngushtë me kurrikulë të procesit edukativo-mësimorë. *FFW* plotëson udhëzimet e të mësuarit tradicionale me ndihmën kompjuterike me softuer të krijuar për të ri-kualifikuar trurin dhe për të përpunuar informacionin në mënyrë më efektive përmes një grupi lojërash kompjuterike që ngadalësojnë dhe zmadhojnë ndryshimet akustike në të folurit normal (Alan Cheung, 2012).

Rishikimi nga Slavin dhe kolegët e tij (2016) ishte i vetmi që aplikoi kritere të qëndrueshme të përfshirjes për t'u përqendruar në studime që plotësonin standarde të larta metodologjike. Në rishikimin e tyre, ata identifikuan rreth 100 studime që krahasuan qasje të

ndryshme për të ndihmuar lexuesit që luftojnë me sfidat e tyre si rrjedhojë e nevojave të veçanta, duke përfshirë mësim mësimorë një për një, udhëzimet për punë grupore, qasje e ndryshme të procesit të përfshirjes në klasë (të tilla si të mësuarit duke bashkëpunuar), reforma gjithëpërfshirëse të shkollës me teknologji. Rreth pesëmbëdhjetë për qind të hulumtimit ishin vlerësime të aplikacioneve të teknologjisë edukativo-arsimore të fokusuara në lexim për nxënësit me nevoja të veçanta të nivelit shkollor fillorë dhe të mesëm. Përfundimi i tyre ishte se teknologjia edukativo-arsimore kishte një ndikim minimal në arritjen e aftësimin për të lexuar, me një madhësi mesatare të efektit të *ponderuar* sipas mostrës së paraqitur prej +0,09 në të gjitha studimet. *Lexia*¹ and *Jostens*² ishin të vetmit dy programe që patën efekte premtuese. Që nga botimi i rishikimit të tyre, disa studime shtesë që plotësojnë standardet e larta metodologjike janë bërë gjithnjë e më të disponueshme.

2.1.1. Implikimet për përgjigjet gjithëpërfshirëse

Pasqyra e përgjithshme që del nga shumica dërrmuese e studimeve përkatëse sugjeron që mësimdhënësit e arsimit të rregullt zakonisht nuk i perceptojnë udhëzimet për të përmbushur larminë e studentëve në klasat e rregullta. Për më tepër, ofrohen disa përshtatje udhëzuese që ata të identifikojnë vështirësitë në të mësuar (deBettencourt, 1999; McIntosh, et al., 1993; Schumm, et al., 1995; Vaughn, et al., 1994)

Mësimdhënësit duket se janë të shqetësuar për gjetjen e mënyrave për t'iu përgjigjur nxënësve pa aftësi të kufizuara duke rritur diversitetin në aspektin e formimit akademik, nivelin e aftësive të zotërimit dhe të interesave. Më e rëndësishmja, ata kryesisht ndihen të pa-buruar dhe të pa-pajisur për të zotëruar këtë detyrë! Sasia e vështirësive që ata tashmë hasin në procesin e mësimdhënies rritet ndjeshëm, kur nxënësit me aftësi të kufizuara përfshihen në klasat e tyre (McLeskey & Waldron, 2002).

Brenda kontekstit të përfshirjes, pranueshmëria e mësimdhënësve për adaptime të ndryshme është një çështje kritike për të kuptuar pse akomodimet bëhen ose nuk bëhen për nxënësit që përballen me vështirësi (Subban, 2006). Si rrjedhojë, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se arritja e të kuptuarit pse mësimdhënësit tentojnë të zbatojnë ose shmangin zbatimin e disa përshtatjeve në klasat e tyre është një proces i vështirë dhe kërkues, kryesisht për shkak të:

¹ Mësimi me Lexim, si grup kompanisë është njëra nga kompanitë më të njohura dhe më të respektuara të teknologjisë së leximit në botë <https://www.lexialearning.com/>

² Jostens. Me sloganin e saj “partneri juaj më i besueshëm” <https://www.jostens.com/about/index>

- kompleksiteti që mbështet vendimet e mësimeve mbi praktikën udhëzuese,
- aspektet shumëpalëshe të mësimit dhe
- ndikimi që ushtrorë karakteristikat unike kon-tekstuale dhe arsimore të sistemeve të ndryshme kombëtare në proceset e vendimmarrjes së mësuesve (Kohler et al., 2008).

Përkundër këtyre ndërlitimeve, analizimi i pranueshmërisë së mësimeve për përshtatjet rutinë është një variabël kyç për të kuptuar kompromisin e tyre në mësimit dhe mësimit nxënësve të ndryshëm në klasat gjithëpërfshirëse dhe për të mësuar në atë masë ata janë të gatshëm të përshtatin dhe të diferencojnë udhëzimet. Për më tepër, mësimit me formës se si i qasen përshtatjeve mund të kontribuojë jo vetëm për të identifikuar preferencën e mësimit, por edhe të pengesave të ndryshme për zbatimin e procesit.

2.1.2. Deficitet e ndjenjave *Magnocelulare*

Një fushë tjetër e cila kërkon trajtim përkrah punimit, është trajtimi i përqendrimit në vështirësitë e nxënësve me nevojë të veçanta (disleksitë) në mënyrën dhe përpunimin e informacionit që ata perceptojnë përmes shqisave (informacioni ndijor); domethënë informacioni që vjen nga të dy veshët (dëgjimor) dhe sytë (vizualë). Ky lloj përpunimi kontrollon nga qelizat e mëdha në rrugët *magnocelulare*, të cilat shkojnë në një pjesë të trurit të njohur si *talamusi*. Diferencat janë gjetur në anatominë disleksitë të trurit si në rrugët vizionare ashtu edhe në ato dëgjimore *magnocelulare* (Albert Galaburda, 1994).

Deficitet e perceptimit me anë të dëgjimit

Bazuar në shumë hulumtimeve dhe hipoteza të ngritura (Tallal, 1980), deficitet fonologjikë është pasojë e një deficiti më themelor në rrjedhën e përpunimit të dëgjimit. Ithtarët e kësaj teorie pohuan se, ashtu si fëmijët e çrregulluar në gjuhë, atyre me disleksi u duhet më shumë kohë për të përpunuar tinguj që ndryshojnë me shpejtësi (Kala Lakshminarayanan, 2007). Nxënësit me disleksi nuk ishin në gjendje të tregonin ndryshimin midis tingujve, dhe kjo vështirësi shoqërohej me vetëdije të dobët fonologjike. Kjo teori potencialisht e rëndësishme tërhoqi një numër përpjekjesh për përsëritje, dhe si pasojë deficitet i dëgjimit tani kuptohet më mirë. Tani është e qartë se nxënësit me nevojë të veçanta, përfshi fëmijët disleksisë mund të kenë edhe vështirësi në të lexuar dhe aftësuar në trajtim të njëjtë me ata nxënës që nuk kanë probleme të tilla. Për shembull, studimi i hartuar me kujdes i Heath, Hogben dhe Clark (1999) zbuloi se fëmijët disleksitë që nuk kishin ndonjë problem shoqëruar të gjuhës orale ishin po aq të mirë sa lexuesit tipikë; në të kundërt, 55% e fëmijëve

me vështirësi të gjuhës orale dhe disleksi përjetuan vështirësi të konsiderueshme, ndërsa pjesa tjetër prej 45% (me dëmtime gjuhësore më pak të rënda) ishin të krahasueshme me fëmijët në zhvillim tipik. Kështu, deficitet e përpunimit të dëgjimit gjenden në mesin e disa fëmijëve me disleksi të cilët gjithashtu kanë dëmtime të gjuhës; por, e rëndësishmja, kjo vështirësi duket se nuk është një shkak i drejtpërdrejtë i vështirësive të tyre të shkrim dhe leximit.

2.1.3. Deficiti i përpunimi i informacionit vizual

Problemi mbi përpunimin e informacionit vizual të nivelit të ulët tek njerëzit me disleksi u identifikua në fillimin e viteve të 90-ta *James Lovegrove*. Gjatë hulumtimeve të zhvilluara ai vëri në dukje problemet vizuale tek nxënësit disleksitë me anë të ndriçimit. Nëse kishte paraqitje jo të rregullta të ndriçimit apo paraqitej ndonjë formë deformuese siç mund të jetë lëvizja e çrregullt e një fotoje – p.sh. dridhjet e fotografisë në ekranin televiziv, me çrastë atyre ju duhet më shumë kohë për të reaguuar apo vërejtur defektin dhe trajtuar si diçka jo e rregullt, thënë thjeshtë, reagimi i nxënësve ishte i vonshëm.

Si rrjedhojë e dallimeve që janë zhvilluar gjatë viteve, posaçërisht në tre dekadat e fundit, kur morri hov të madh edhe zhvillimi i teknologjisë informative, implikimi i qartë i lëvizjes së arsimit gjithëpërfshirës është se shkollat e zakonshme kërkojnë të ristrukturohen në mënyrë që të sigurojnë një larmi në rritje të nevojave arsimore dhe të eliminojnë problemin e nxënësve që nuk arrijnë të përmbushin potencialin e tyre të të mësuarit (Avramidis et al., 2000). Gjithsesi, përkundër avokimit të gjerë të përfshirjes në ligjërimin arsimor dhe udhëzimet e politikave, çështja se si nevojat divergjente të fëmijëve plotësohen më mirë brenda sistemeve edukativo-arsimore ende mbetet një çështje mjaft e diskutueshme.

Që ato dyshime të vihen në diskutim, numër i konsiderueshëm autorësh (Ainscow, 2007; Dyson & Millward, 2000; Low, 2007) kanë argumentuar që kjo ka të bëjë më shumë me zbatimin e dobët të programeve gjithëpërfshirëse, sesa me kundërshtimet ndaj konceptit për përfshirjen e tyre dhe nismën e procesit për ndryshime. Në anën tjetër, në përgjithësi janë pajtuar që mësimdhënësit duhet të kenë një repertor gjithnjë e më të madh të strategjive udhëzuese për të përmbushur nevojat divergjente të nxënësve - në botën e zhvilluar ndoshta kjo ka kuptim – por jo edhe tek ne në Kosovë. Pak informacion përshkrues është i disponueshme në lidhje me llojet e përshtatjeve mësimore që janë të nevojshme në zbatimin e një programi shkollor gjithëpërfshirës. E i kufizuar mbetet gjithashtu informacioni në lidhje me llojet dhe efektivitetin e përshtatjeve mësimore në praktikën e përditshme të

mësimdhënësve, brenda klasave të tyre, e posaçërisht nëse aty ka nxënës me nevoja të veçanta.

2.1.4. Hapat lehtësues për trajtimin e procedim edukativo-arsimorë me nxënës me nevoja të veçanta

Autorë të shumtë të cilët hulumtojnë mënyrat për trajtimin më të mirë dhe më praktik për të lehtësuar procesin edukativo-arsimorë si në klasë gjatë procesit mësimorë, po ashtu edhe duke shfrytëzuar teknologjinë informative për mësim nga distanca, çoftë punë individuale me nxënës - një për një - apo punë në grupe, kanë identifikuar disa hapa konkret, të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të cilët përveç që kanë treguar rezultate pozitive me nxënësit me nevoja të veçanta, kanë joshur edhe më shumë nxënësit e rregullt duke ngritur cilësinë e mësimnxënies në përgjithësi. Hapat e përmendur gjerësisht janë:

1. Trajtimi i një detyre – udhëzimi – të vetme deri në finalizim
 - Kështu ndihmoni, ulja e kohës për përpunimin e informatave për nxënësit me nevoja të veçanta dhe plotëson *deficitin* në kujtesën e tyre
2. Ofroni paraqitje vizuale të të gjitha diskutimeve - sqarimeve - sa herë që kjo është e mundur
 - Shpjegimet e dhënë gjatë procesit të mësimdhënie mbahet mend më lehtë kur përcjellët edhe vizualisht. Ky proces është pak-a-shumë i detyrueshëm kur aktiviteti i procesit të mësimdhënies bëhet me teknologji informative, posaçërisht për mësim nga distanca, por jo domosdoshmërisht.
3. Përsëritja dhe rishikimi punës së realizuar
 - Përsëritja e të trajtuarës ditore i ndihmon nxënësit të organizohen, të filtrojnë dhe përcaktojnë më mirë përparësitë e tyre. Ndërsa me rishikim ndihmojmë në lidhjen praktike, zhvillimin e kujtesës dhe kategorizimin e detyrave të caktuara
4. Paralajmëroni nxënësit që aktiviteti do të ndryshoj
 - Edhe pse duket - posaçërisht me nxënësit me nevoja të veçanta - që ndryshimet e shpeshta krijojnë konfuzione, ato janë të nevojshme. Ajo që është shumë e rëndësishme është paralajmërimi. Për shembull: edhe pesë minuta dhe do të fillojmë me leximin e autorit “x”, po afron koha, edhe dy

minuta... vazhdojmë. Paralajmërimi zhvillon përgatitjen e plotë dhe eliminon çdo pengesë, derisa mbanë përqendrimin në nivel të kënaqshëm.

5. Shmangni të zakonshëm, ofroni dinamikë me ndryshime të shpeshta në aktivitete
 - E zakonshmeja nënkupton procesin klasik të mësimdhënies, pa përfshirë nxënësit në ekuacionin debutues. Duke përfshirë nxënësit në procesin e ndryshimeve dhe duke bërë ndërrime të aktiviteteve çdo dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta, mbani kureshtjen e nxënësve gjithnjë aty ku është e nevojshme
6. Siguroni edhe përshkrimin vizual me shënime ose kërkoni alternativa që për nxënësit të mbahen shënime e diskutimeve
 - Çdo udhëzim, ligjëratë, detyrë apo diskutim që zhvillohet në procesin e mësimin, nëse përcjellët edhe me formë të shkruar mbahet mënd më gjatë dhe më lehtë, prandaj sigurohu që teksti për temën të cilën jeni duke e diskutuar është i disponueshëm, nëse jo, bëhuni kreativ dhe jeni mënyrën që kjo të behet aty për aty. P.sh. angazhoni njërin nga nxënësit që të mbaj shënime mbi diskutimet dhe pastaj të shpërndaj ato me klasën
7. Nga dalësoni ritmin e mësimdhënies
 - Sigurohu që nxënësit e kanë kohën e mjaftueshme që të absorbojnë atë që po ju ligjëroni në klasë. Bëhuni i drejtpërdrejtë dhe i qartë në mesazhin tuaj. Kërkoni pjesëmarrjen e nxënësve në diskutim deri sa të siguroheni që informata juaj ka depërtuar dhe është kuptuar drejtë.
8. Ndal supozimet dhe lidhni secilën temë me gjëra praktike
 - Asnjëherë mos supozoni që nxënësit e kuptuan atë që ju e dhatë, është pikërisht ky hendeku që mund t'i dëmtoj nxënësit tuaj. Bëhuni të qartë me të gjitha mësimet, mos u ndalni vetëm me sqarime. Mësoni nxënësit tuaj koncept pas koncepti duke u siguruar që është kuptuar dhe është krijuar lidhshmëri me shembullin që keni marrë për konceptin e trajtuar.

Këto tetë hapa – veprime – janë bërë pjesë e patjetërsueshme e shumë institucioneve edukativo-arsimore e posaçërisht ato që ballafaqohen me sfida të ndryshme si rrjedhojë e nevojave të veçanta që kanë nxënësit e tyre. Autorë të shumtë gjatë hulumtimeve shkencore dhe punëve të tjera të cilat i përcjellin, dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre në këtë fushë,

rekomandojnë lehtësime të vazhdueshme për mësimdhënësit që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta. Rekomandimi i përbashkët i cili dominon në shumicën e rasteve është infrastruktura dhe adaptimi i qasjes për të krijuar modalitete të njëjta dhe të mos bëhen dallime të theksuara me anë të të cilave diferencohen fëmijët me nevoja të veçanta nga të tjerët.

2.2. ZHVILLIMET E FUNDIT DHE QASJA NË PLATFORMAT INTELIGJENTE

Sistem i bazuar në profilizimin e nxënësit dhe përshtatjen e burimeve të të mësuarit është proces që ka filluar së zhvilluari nga fillimi i shekullit XX, dhe është intensifikuar dhe popullarizuar posaçërisht gjatë vitit 2020, si rrjedhojë e detyrimit dhe imponimit të ndryshimeve rrënjësore në mënyrën e të jetuarit.

Të gjithë jemi duke u ballafaquar me faktin e zakonshëm, që zhvillimet teknologjike po shkaktojnë ndryshime të vazhdueshme në çdo sektor të shoqërisë moderne. Vetë sistemi edukativo-arsimorë nuk mund të mbetet pasiv, kjo pa dyshim i pa gjatë vitit 2020. Të gjitha teknikat tradicionale të mësimdhënies po rishikohen dhe po rivlerësohen dhe ato janë bërë temë e diskutimeve mbarë-globale. Aplikacionet e orientuara në internet përpiqen të kënaqin nevojat aktuale edukativo-arsimore duke mbyllur hendekun midis teknikave tradicionale dhe tendencave të ardhshme në arsimin e përzier me teknologji. Ky proces është i brishtë kur bëhet fjalë për nxënësit me nevoja të veçanta, por gjithsesi, nuk është çështje e cila do ta ndryshoj procesin tani më të filluar. I tërë sistemi edukativo-arsimorë është ndikuar nga pandemia e corona-virusit dhe me shpejtësi të pa parë asnjëherë janë bërë ndryshime dhe adaptime në procesin e edukimit dhe arsimimit të të rinjve kudo që janë. Fatmirësisht, teknologjia informative edhe pse jo krejtësisht e plotësuar për t'i bërë ballë sfidave ishte prezentë dhe ndikoj në ndryshimin e përgjithshëm.

Drejt këtij qëllimi, sisteme të ndryshme të e-mësimit janë zhvilluar gjatë viteve të fundit, megjithatë, shumica e tyre formojnë aplikacione që i përkasin “modës” së vjetër, duke munguar funksionalitete si mjedise edukativo-arsimore multimediale, aftësi të personalizuar dhe gjurmimi e reagimeve të rëndësishë së nxënësve. Mbështetja e personalizuar për nxënësit bëhet edhe më e rëndësishme, kur e-mësimi zhvillohet brenda rrjeteve të hapura dhe dinamike të të mësuarit dhe informacionit nuk ka kontrollin e nevojshëm. Sidoqoftë, shumica e sistemeve të e-mësimit (Dagger et al., 2003; Henze & Nejd, 2001; Weber, Kuhl, &

Weibelzahl, 2001), modelojnë nxënësin si një entitet të shoqëruar nga një grup interesash dhe opsionesh të paracaktuara statike, pa u kushtuar vëmendjen e duhur nevojave të tyre. Për më tepër, të mësuarit e personalizuar duke përdorur informacionin e shpërndarë në mjedise dinamike të të mësuarit është ende një problem i pazgjidhur në hulumtimin e e-mësimit, vendosni këtu në ekuacion nxënësit me nevoja të veçanta - asnjë nga sistemet ekzistuese nuk është ndihmesë aktualisht. Disa qasje në drejtim të sistemeve edukativo-arsimore të bazuara në teknologji informative, janë duke u përpjekur të ofrojnë qasje të personalizuar dhe lehtësim mbi prezantimin e burimeve të mësuarra për fusha specifike. Mungesa e vlerësimit automatik të profilit të nxënësit dhe sigurimi i burimeve të përshtatshme të mësimnxënies është një fenomen i zakonshëm në këto sisteme.

2.3. MOTIVIMI PËR MËSIMDHËNËSIN

Posaçërisht tani, sistemi edukativo-arsimor përballet vazhdimisht me sfida të reja, duke e shtyrë atë të rindërtohet në mënyrë që të përshtatet me universin dinamik që vazhdon dhe zhvillohet para syve tanë. Prandaj, mësimsdhënësit si figura kryesore të sistemit janë të detyruar të përshtaten me realitetin e ri dhe të kërkojnë mënyra për të u zhvilluar në mënyrë që të realizojnë shtrirjen e punës së tyre në mënyrë profesionale dhe për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve të cilët nuk i shikojnë më ata vetëm për hir të arritjes së informacionit - pasi që kjo lehtë mund të gjendet në mënyrë të pavarur - por si model të cilët janë përgjegjës për t'iu ofruar me dinjitet mbështetjen e nevojshme. Fenomeni i mungesës së motivimit të mësimsdhënësve, i cili deri tani mund të injorohej lehtësisht pa pasur nevojë të shkatërrohet sistemi edukativo-arsimor duhet të rishikohet dhe zgjidhjet e reja duhet të vijnë në konsideratë – shih çfarë ndryshimi u imponua nga situata e ballafaqimit me pandeminë e vitit 2020.

Në pothuajse të gjitha profesionet, e posaçërisht atë të mësimsdhënësit dukuritë e përplasjeve tronditëse midis një imazhi të *shtrembëruar* dhe *idealizuar* që praktikisht janë në vend, ndryshon vetëm pasi të ketë përfunduar periudha e trajnimeve freskuese. Plotësohet imazhi dhe del personaliteti i kërkuar nga nxënësit me krijimin rifreskues që transmeton mësimsdhënësi. Sa i përket *djegies*³ së mësimsdhënësve, çështja e djegies ishte trajtuar nga këndvështrime të ndryshme, duke përfshirë faktorë ndikues brenda sistemit edukativo-arsimor nga studiues të ndryshëm në po thuajse gjithë botën.

³ i referohet një gjendjeje të lodhjes emocionale, fizike dhe mendore të shkaktuar nga stresi i tepruar.

Meqenëse motivimi është element kritik i arritjes së qëllimeve në fushën pedagogjike, mund të supozohet se një aspiratë më e rëndësishme e sistemit edukativo-arsimor është zgjedhja e mësimdhënies përtej motivimit. Përveç kësaj, roli i tanishëm i mësimdhënësit ka pësuar një metamorfozë kërkuese përballë hyrjes së shpejtë në mediat e mëdha, duke u shtyrë të lëvizë përveç dhënies së informacionit që ishte bërë praktikisht pothuajse i tepërt në epokën e *Google*, në aspekte arsimore më sfiduese të tilla si stimulim i motivimit të nxënësve për të mësuar, kurioziteti i tyre për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin përkatës dhe përfundimisht, duke lehtësuar vullnetin e tyre për të aspiruar vetë-realizim.

Rëndësia e zhvillimit personal në mësimdhënie përforcohet në dritën e realitetit të jetës sot, karakterizohet nga mungesa e stabilitetit dhe ndryshimeve të shumta, realiteti në të cilin termi "karrierë" merr një kuptim tjetër! Jo më një karrierë, e cila është e qëndrueshme gjatë gjithë jetës, por një karrierë dinamike. Një realitet në të cilin java e punës shkurtohet dhe ka më shumë orë të lira. Në një realitet në të cilin punonjësit nuk janë të detyruar të shkojnë në vendin e punës por mund të punojnë edhe nga shtëpia, puna duhet të marrë një kuptim tjetër nga më parë. Sot, njerëzit shohin në punë një vend që mundëson zhvillimin personal dhe vetë-realizimin. Prandaj, karakteristikat e realitetit post-modern duhet gjithashtu të gjejnë shprehjen e tyre në sistemin edukativo-arsimor. Profesionit i mësimdhënësit duhet të përfshijë një horizont zhvillimor që do të shprehej në kurset e avancimit të tyre për të parandaluar funksionimin në kushte pakënaqësie, për të krijuar motivim mes mësimdhënësve dhe për të krijuar një funksionim optimal.

2.3.1. Motivimi si shtytje

Hulumtimet dhe teoritë e hershme u kanë dhënë rëndësi nevojave për të kuptuar motivimin njerëzor. Nevoja përcaktohet si kërkesë për diçka që një individ kërkon dhe dëshiron.

Një nevojë lind brenda një individi kur ekziston një çekuilibër midis një gjendjeje të brendshme mendore dhe një gjendjeje të dëshiruar, e cila i siguron një individi rezultat të dëshiruar dhe tërheqës. Nevoja mund të përkthehet për të drejtuar një orë mësimi..

Maslow thekson që nevoja për një diçka është e lindur. Qasja e tij bazohet në një hierarki të nevojave: një seri qëllimesh që ka një individ, të cilat përbëjnë nevojat e tij themelore. Disa prej tyre janë nevoja të "mungesës", të tilla si, nevoja fiziologjike të urisë ose nevoja psikologjike të vetë-vlerësimit dhe përkatësisë; disa nga këto nevoja rrjedhin nga "rritja", e cila e shtyn një individ të zhvillojë potencialin e tij të brendshëm.

Hierarkia buron nga parimi që nevojat, në çdo nivel, duhet të përmbushen përpara se të aktivizohet nevoja e shkallës tjetër në shkallë. Sa më shumë që plotësohen nevojat fiziologjike dhe e sigurisë, aq më shumë intensiteti i nevojës do të ulet dhe forca lëvizëse e përkatësisë, njohjes dhe vetë-përmbushjes do të rritet. Në krahasim me nevojat e mëparshme, nevoja për vetë-realizim nuk ka kufij kënaqësie. (Anne-Christine Cadiat, 2015)

Sipas (Bandura, 1977) "të mësuarit e individual" është proces i marrjes së përgjegjësisë dhe kontrollit personal, që natyrisht mund të ndikohet nga mjedisi. Ai pranon që dy faktorë të rëndësishëm ndikojnë në sjelljen e një individi:

3. Vetë-rregullimi: individi ka mundësinë e rregullimit të ndikimit të mjedisit shoqëror mbi të dhe përcakton drejtimin e sjelljes së tij në dritën e qëllimeve që ai i vendos vetes. Sipas mendimit të tij, ai është një produkt i proceseve të jashtme (mjedisore) dhe të brendshme (individuale).
4. Vetë-aftësia: merret me dijeninë që një individ është i aftë të ekzekutojë një detyrë të caktuar.

Ne jemi duke jetuar në kohë me mundësi të pashembullta për të komunikuar me të tjerët në fusha autentike dhe pavarësisht gjuhëve dhe/apo kulturave të kontekstualizuara. Teknologjia ka qenë gjithmonë pjesë integrale e jetës sonë. Teknologjia ka një marrëdhënie reciproke me mësimdhënien. Shpikja e teknologjive të reja i ndihmon nxënësit të kuptojnë përmbajtjen e temave që trajtohen dhe të arrijnë rezultate të mira në klasë. Aktualisht, teknologjia rrethon njerëzimin. Teknologjitë kompjuterike kanë ndryshuar mënyrën se si njerëzit marrin informacion dhe komunikojnë me njerëz në të gjithë botën. Për këtë arsye, shkollat dhe institucionet arsimore duhet të jenë të vetëdijshëm për pajisjet teknologjike, dhe duhet që këto mundësi të integrojnë në të njëjtin proces edhe fëmijët me nevoja të veçanta.

Përdorimi i teknologjisë, si një strategji mësimore në klasë tanimë është bërë proces i njohur. Ai mbështet procesin e të mësuarit midis nxënësve dhe mund të përdoret në forma të ndryshme për të përmirësuar aftësitë e të kuptuarit në përmbajtjen e materies që trajtohet (Hicks, Reid, & George, 2011).

Kohëve të fundit, e posaçërisht gjatë dekadës së fundit, të mësuarit e një gjuhe të huaj është proces shumë i rëndësishëm, në rastin e kosovarëve, vjen në shprehje absolute gjuha angleze dhe ajo gjermane. Mësimi i një gjuhe të re jo vetëm që zhvillon inteligjencën individuale, por gjithashtu lehtëson hyrjen e nxënësit në një kulturë tjetër dhe i përgatit nxënësit me aftësitë thelbësore për të pasur sukses dhe për të ndryshuar sjelljen e tyre në një

botë që ndryshon me shpejtësi (Chan & Herrero, 2010), kjo është veçanërisht e theksuar kur suksesi dëshmohej me rastet e trajtimeve të fëmijëve me nevoja të veçanta. Vizualizimi ndihmon në përmirësimin e kujtesës, rivendosjen e shëndetit, zvogëlimin e stresit, rritjen e relaksimit dhe motivimit. Natyrisht kjo ndihmon në mënyrë të drejt-për-drejtë në shëndetin dhe trajtimin mbi shëndetin në përgjithësi e posaçërisht për fëmijët me nevoja të veçanta. Vizualizimi ndihmon në motivimin e individëve, siguron praktikë mendore që gjithashtu mund të jetë me kosto efektive dhe më e sigurt.

2.3.2. Faktorët që kontribuojnë në nivelin e pranimit të teknologjisë në institucionet edukativo-arsimore

Një punim kërkimor i titulluar 'Faktorët që Kontribuojnë në Nivelin e Pranimit të Teknologjisë në Shkollat Private të Pasura' e punuar nga autorët Margaretha Gertruida Johanna Maré & Maryke Anneke Mihai synon të eksplorojë faktorët që ndikojnë në pranimin e teknologjisë të mësuesve që janë të punësuar në një shkollë ku ka një qasje të gjerë ndaj llojeve të ndryshme të teknologjisë. Studiuesi synoi të identifikojë aspekte të dallueshme që pengojnë përdorimin e teknologjisë në dispozicion, ndërsa vendosi gjithashtu faktorët motivues në shkollën e synuar. Intervistat gjysmë të strukturuar u zhvilluan me pesë vullnetarë divergjentë. Intervistat e transkriptuara u analizuan në mënyrë cilësore duke përdorur Atlas për të ndihmuar në identifikimin e modeleve në zhvillim. Përmes analizave u bë e qartë se megjithëse mësimdhënësve u prezantohet teknologjia dhe e njohin dobinë e saj, të metat në mbështetje nga institucioni gjithnjë e më shumë i pengojnë mësimdhënësit me një pranim të teknologjisë së lartë nga përdorimi i teknologjisë në dispozicion. Studiuesi rekomandoi që anëtarët e menaxhmentit duhet të vendosin qëllime të qarta të zbatimit për anëtarët e stafit, ndërsa i përkushtohen vetes për të dhënë prioritetin e nevojshëm në çështje të tilla si infrastruktura, mirëmbajtja e pajisjeve dhe mundësitë efektive të trajnimit.

2.3.3. Njohja e fushëveprimit të arsimit për nxënësit me nevoja të veçanta

Edukimi special përfshin shumë shqetësime të ndryshme edukativo-arsimore dhe përfshijnë të gjitha grup-moshat, nga fëmijëria e hershme deri në moshë të shtyrë. Do të jetë e nevojshme mbështetja për disa nxënësve vetëm për t'i mundësuar ata të arrijnë një nivel të komunikimit bazë me njerëzit përreth tyre. Për të tjerët që ndihmohen në zhvillimin e njohurive themelore të nevojshme për t'u angazhuar më thellësisht me botën e punës. Dhe për të tjerët, kjo mund t'i ndihmojë ata të integrohen normalisht në shoqëri përmes një procesi të socializimit dhe kontrollit të sjelljeve të papranueshme.

2.3.4. Ndryshimet e imponuara

Akti i Edukimit për Individët me Aftësi të Kufizuara (*The Individuals with Disabilities Education Act - IDEA*) është një ligj që vë në dispozicion arsimimin publik falas dhe të përshtatshëm për fëmijët e kualifikuar me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin dhe siguron arsim special dhe shërbime të ngjashme për ata fëmijë.

2.3.5. Qëllimi prapa IDEA-së është:

Citim nga faqja zyrtare e IDEA

- *të siguroj hapësirë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të iu ofroj të gjithë atyre mundësi për dhe qasje në edukimin publik, që thekson aspektet speciale dhe shërbimet përkatëse të krijuara për të përmbushur nevojat e tyre unike dhe për t'i përgatitur ata për arsim të mëtejshëm, punësim dhe jetë të pavarur;*
- *të siguroj mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të fëmijëve të tillë;*
- *të ndihmojë autoritetet në zbatimin e sistemit gjithëpërfshirës, të koordinuar mbi shërbimet për ndërhyrje të hershme për foshnjat dhe fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;*

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është aplikuar ndryshimi i bazuar në ligj për nxënësit në shkolla me mjedise gjithëpërfshirëse, dhe ky fakt ka ndikuar në përfshirjen e lehtësuar të nxënësve me aftësi të kufizuara. Qysh prej vitit 1997 kur është ri-formuluar Ligji i Arsimit për Individët me Aftësi të Kufizuara (IDEA), shumë mësimdhënës duhet të bëjnë përshtatje për nxënësit me nevoja të veçanta për të mundësuar të mësuarit në mjedisin e arsimit të përgjithshëm. Mësimdhënësit e përgjithshëm dhe ata special duhet të punojnë në bashkëpunim për të hartuar procese dhe punë të shtuar që të bëjnë përshtatjet e nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara për të cilët kërkohet trajtim special. Njëkohësisht mësimdhënësit duhet të adaptojnë mënyra pune në mënyrë që të përshtatin edhe ato kategori të nxënësve që konsiderohet se janë në rrezik ose që kanë nevoja të ndryshme për të mësuar. Këta nxënës mund të mos shërbehen në një program të edukativo-arsimor special, megjithatë mësimdhënësit ballafaqohen me forma të ndryshme pune duke bërë përshtatjet e nevojshme për këta nxënës, si dhe për nxënësit që identifikohen për trajtim special. Institucionet edukativo-arsimore efektive krijojnë udhëzime që plotësojnë nevojat individuale të të gjithë nxënësve, përfshirë ata me nevoja të veçanta (Weber, 1971).

Një institucion edukativo-arsimorë, thënë më thjeshtë, një shkollë e mirëfilltë efektive, është organizatë e larmishme për zgjidhjen e problemeve, e cila ka një mision të përbashkët që thekson të mësuarit për të gjithë nxënësit. Punëson dhe mbështet mësimdhënësit dhe anëtarët e tjerë të stafit të cilët janë të përkushtuar të punojnë së bashku për të krijuar dhe mbajtur një klimë të favorshme për të mësuar. Përgjegjësia për të gjithë nxënësit është e përbashkët. Një shkollë e mirëfilltë pranon që një angazhim i tillë kërkon udhëheqje administrative, ndihmë të vazhdueshme teknike dhe zhvillim profesional afatgjatë.

Në Kosovë, dhe konsideroj që edhe në Shqipëri dhe në shtetet në zhvillim përgjithësisht, që të aplikohet mënyra e drejt-për-drejta në përfshirjen në rregullimin e procesit edukativo-arsimorë, kërkohet që përvoja e vet mësimdhënësit të thellohet në ndërtimin e kurrikulës dhe proceseve të tjera edukativo-arsimorë. Tani për tani, kurrikulë për procesin e mësimit për klasat 1-5, 6-9 dhe 10-12 mësimdhënësve iu shërbehet të plotësuar me udhëzime të cekëta për zbatim! (Autori, 2021). Trajtimi i përvojës, padyshim dëgjohej por nuk merret në konsideratë. Institucionet që drejtojnë shkollat në nivel vendi, nuk janë plotësisht të mishëruar me procesin edukativo-arsimorë, e lëre më konsideratën për trajtimet speciale për nxënësit me nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit shpesh duhet të bëjnë përshtatje në kurrikulë dhe bëjnë udhëzime në përpjekjet e tyre për t'i mbajtur nxënësit të angazhuar në mënyrë aktive në orë mësimore. Përpjekjet për përmirësimin e shkollës të cilat përqendrohen në hulumtimin efektiv të shkollave bazohen në nocionin që të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta, mund të mësojnë.

Ka shumë raste kur është e përshtatshme dhe e nevojshme që mësimdhënësit duhet të bëjnë adaptime të kurrikulës për mësim-nxënie të qëndrueshme. Kur mësimdhënësit marrin vendime në lidhje këtë, natyrisht që është e vështirë dhe në raste të shumta e pa tej kalueshme për ndryshim të përgjithshëm, e në raste të tilla duhet të mbahet lidhja efektive e shkollës me pritjet që ka për nxënësit. Kjo përfshin ngritje në të pasurit pritje më të larta për nxënësit me aftësi të kufizuara (Scruggs, Mastropieri, & Sullivan, 2014). Është e nevojshme që të bëhen adaptime për të iu përshtatur objektivave dhe përmbajtjes duke u mbështet në metodat e shpërndarjes udhëzuese kur nxënësit nuk janë të suksesshëm në mjedisin e arsimit të përgjithshëm (Deschenes et al., 1994). Përshtatjet shpesh janë të nevojshme nëse nxënësit që marrin trajtim special dhe marrin udhëzimet e duhura në fushat e përmbajtjes. Stainback, Stainback dhe Stefanich (2016) raportojnë se të mësuarit e lëndëve thelbësore të tilla si

studimet shoqërore, shkenca dhe matematika me kolegët është më e dobishme në planin afatgjatë për nxënësit me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe rastet më të rënda.

2.3.6. Përdorimi i teknologjisë në arsimin special: Zbatimi dhe zgjidhjet

Në këtë pjesë të punimit flasim edhe për çështjet e prekshme në sistemin edukativo-arsimorë, ndikimin, zbatimin dhe zgjidhjet që bëhen me përfshirjen e teknologjisë dhe nxënësit. Sot, jemi të gjithë dëshmitarë që nuk ka kufij të cilët shkaktohen në barriera, përkundrazi, jemi të hapur me tërë globin. Në ditët e sotme, pothuajse çdo person, pavarësisht nga ku është apo në çfarë gjendje fizike është, mund të marrë shërbime edukativo-arsimore, dhe të tjera në të gjithë botën. Për të rregulluar marrëdhënie të tilla midis një personi dhe organizatave ndërkombëtare, ka qindra agjenci të specializuara që na kufizojnë me ligje dhe standarde ndërkombëtare me anë të të cilave i mbrojnë të gjitha palët.

Standardet arsimore pretendojnë se nxënësve me aftësi të kufizuara duhet t'u ofrohen mundësi për të realizuar potencialin e tyre. Ata duhet të marrin pjesë në arsim dhe trajnim në të njëjtën bazë si studentët pa aftësi të kufizuara dhe se nuk janë subjekt i diskriminimit. Për shkak të përparimit në industrinë e Teknologjisë Informative (TI), teknologjitë digjitale janë lehtësisht të arritshme dhe të përhapura, gjë që lejon përdorimin e tyre për t'u ofruar nxënësve mundësi të reja.

2.3.7. Si teknologjia thjeshton procesin arsimor për personat me aftësi të kufizuara.

Qendra e statistika në pothuajse çdo shtet paraqet numra dhe vlera për kategori të ndryshme, p.sh. në ShBA llogaritet që rreth 13% e nxënësve në sistemin e arsimit janë nxënës me aftësi të kufizuara (Qendra Kombëtare të Statistikave të Arsimit, ShBA, 2016). Një informatë të tillë nuk e gjejmë dot në Entin Statistikorë të Kosovës! Prandaj edhe fokusi që kjo kategori, nxënësit me aftësi të kufizuara, trajtohet në mënyra të veçanta në vendet e zhvilluara.

Bazuar në diskutimet që zhvillohen në Kosovë për nxënësit me aftësi të kufizuara, numri i tyre duhet të jetë shumë i vogël, posaçërisht në raport me atë në ShBA, megjithatë, kjo nuk do të thotë që duhet të kemi standarde tjera. Fëmijët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara dihet të jenë të qasshëm në të gjitha fushat, pa asnjë lloj diskriminimi. Teknologjia ndihmon, gjithsesi, nuk mund të ketë një zgjidhje të vetme teknologjike që do t'i përshtatet nevojave të të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta. Për shkak të larmisë së lartë të llojeve të aftësive të kufizuara, rezultati më i mirë i mundshëm mund të garantohet nga përdorimi i

zgjdhjeve të bëra me porosi të hartuara në përputhje me kërkesat e një grupi të veçantë të nxënësve.

Teknologjia speciale lejon rritjen e pavarësisë së një nxënësi të veçantë duke e çliruar atë nga nevoja e vazhdueshme për përfshirje të drejtpërdrejtë të mësuesit. Si rezultat, një nxënës mund të zgjedhë shpejtësinë e të mësuarit që është i përshtatshëm për të, gjë që çon në një mësim më të personalizuar. Kur nxënësi nuk pengon procesin e të mësuarit për të gjithë grupin, kjo lejon uljen e nivelit të ankthit i cili luan një rol të rëndësishëm edhe në edukim dhe arsimim. Zbatimi i teknologjive në arsimin special lejon thjeshtimin e komunikimit dhe përmirësimin e aftësive akademike të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Perceptimi i arritjeve individuale nga potenciali dhe forma e qasjes dhe shfrytëzimit të ndihmës që buron nga teknologjia, kryesisht ndahet në tre aspekte:

- Përmirësimet në fusha me mbështetje nga teknologjia
- Teknologji si mjet ndihmës për të mësuar dhe aktivitetet në klasë
- Teknologji si mjet ndihmës në lëvizje

Teknologjia ndihmon në lexim, shkrim, dëgjim, matematikë, organizim, qasje, ndërlikime sociale, pjesëmarrje dhe shumë fusha të tjera, dhe njëkohësisht, ia ofron komoditetin nxënësit që mos të mundohet shumë të mbaj në mend informatën - e nevojshme - sepse e gjen prapë.

Në klasë natyrisht përveç të sipër përmendurat, krijon mundësinë e përfshirjes edhe me atmosferën e krijuar në klasë. Duke marrë si shembull elementet më të thjeshta siç është ndriçimi, qasja e prekjes së ekranit dhe ndërveprimi të një funksioni të caktuar (ndarja e monitorit në dy pjesë, rritja apo zvogëlimi i pamjeve, përfshirja në lojëra me klasën, nxitja me nxjerrje të rezultateve etj. Ndërsa ajo që e bën mrekullinë me zhvillimet e teknologjisë është patjetër qasja që i ofrohet nxënësve në lëvizje, posaçërisht nxënësve me aftësi të kufizuara apo atyre me nevoja të veçanta duke iu ofruar qasje të lehte me dyer elektronike që hapen me prezencën e nxënësit dhe identifikimin e tyre çoftë me kartelën e nxënësit apo ndonjë formë tjetër biometrike, karroca, hapje të laura-ve dhe qasje në pajisje të teknologjisë informative në hapësira të përbashkëta.

Edmentum është gjiganti me përvojë të thellë në zhvillimin e procesit të mësimnxënies nga distanca *eLearning*, nga i cili citojmë:

“Teknologjia bën të mundur që një klasë të përmirësohet me ngjarje individuale të të mësuarit, duke i lejuar mësimdhënësit të

sigurojnë fleksibilitet dhe diferencim më të madh në mësimdhënie. Mësimdhënësit mund të përdorin teknologjinë për të ofruar një larmi mundësish dhe qasjesh të të mësuarit me të cilat angazhojnë, udhëzojnë dhe mbështesin nxënësit e arsimit special me një mori taktikash të dizajnuara për t'u tërhequr mësimnxënies individuale. Nxënësit nuk janë më të mbërthyer në një klasë që nuk e kuptojnë, duke u përpjekur të mësojnë me një ritëm që nuk mund të ecin me të ose të marrin pjesë."

2.3.8. Thyerja e barrierave me zbatimin e TI në procesin edukativo-arsimorë

Ka shumë mënyra sesi TI mund të ndihmojë nxënësit me nevoja të veçanta. Për shembull, disa lloje të aftësive të kufizuara nuk i lejojnë studentët të përdorin tekst të shkruar me dorë që është një pjesë integrale e procesit të të mësuarit "tradicional". Duke përdorur mjete teknike të destinuara për njohjen dhe sintetizimin e fjalës njerëzore, ju mund të shmangni domosdoshmërinë e përdorimit të letrës dhe lapsit gjatë mësimeve. Një teknologji e tillë do të ishte e dobishme edhe për nxënësit me çrregullime që nuk lejojnë të përpunojnë saktë informacionin vizual.

Teknologjia lejon përdorimin e pajisjeve digjitale për të anashkaluar detyra sfiduese. Programet siç është JAWS (lexues i tekstit në ekran) së bashku me tastierë (Brail) të dizajnuar posaçërisht për ata që kanë probleme me të pamurit, krijon mundësinë që nxënësi të shkruaj dhe lexoj pavarësisht këtij kufizimi fizik duke përdor kompjuterin.

Ndërsa sistemet e komunikimit plotësues ndihmojnë nxënësit me probleme të të folurit për të kapërcyer pengesën e komunikimit. Sisteme të tilla përdorin skema figurash, libra dhe kompjuterë të specializuar që ofrojnë funksione të parashikimit të fjalës për një komunikim më efektiv.

2.3.9. Shembuj të bazuar në faqe të ndryshme për zgjidhje të edukimit special

Për shkak që aftësitë e kufizuara nuk janë të njëjta për të gjithë, por ato dallojnë shumë nga njëra-tjetra, nxënësit me nevoja të veçanta mund të përballen edhe me çështje që lidhen me lëvizjen kur flasim për distanca të ndryshme. Zgjidhjet e të mësuarit të bazuara me qasje përmes platformave të ndryshme në internet lejojnë ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore duke marrë parasysh interesat e nxënësve dhe institucioneve që ofrojnë ato shërbime. Detyra është t'u ofrojë nxënësit mjete adekuate që mund të shfrytëzohen lehtësisht dhe që kanë karakter nxitës me çrrestë edhe blerja e disa *kurseve* shtesë në internet, dhe caktimi për

përcjellje të progresit akademik fuqizon arsyen për investime të tilla. Një shembull i një zgjidhjeje për të këtë çështje është *Zoom* - një program inovative për biseda, i bazuar në internet me mundësinë për të komunikuar lehtësisht audio/video dhe me tekst. Natyrisht, viti 2020 me ndryshimet e imponuara ka hap perspektive të gjerë mbi këtë formë të komunikimit dhe kjo sot mund lehtësisht të konsiderohet si pjesë e patjetërsueshme e jetë. *Dhomat* e bisedave çdo herë me kapacitete më të mëdha fillimisht kishin potencialin që të lidhnin në një dhomë virtuale deri në pesë përdorues – pra kryesisht pune me grupe të vogla. Në rast nevojë për seanca individuale, mësimdhënësi ose nxënësi mund të fillojnë një bisedë të re një-për-një. Duke përdorur funksionin e ndarjes së ekranit, mësimdhënësi mund të demonstrojë prezantime për të gjithë në dhomë. Aplikacioni gjithashtu lejon regjistrimin e mësimeve, kjo do të thotë që përmbajtja mbetet e arritshme pasi të jetë dorëzuar.

2.3.10. Vlerësimet dhe matja e arritshmërisë

Procesi i teknologjisë, posaçërisht pjesa për vlerësime të arritjes së sukseseve nga nxënësit të cilët e ndjekin procesin nga distanca, është sfidë në vetvete. Përkrah matjeve dhe vlerësimeve që bëjnë mësimdhënësit, krijon mundësi dhe hapësirë - nëse nuk menaxhohet mirë - për mashtrime apo keqpërdorim të rrethanave dhe si rrjedhojë matjet as për nxënësin në njërën anë e as për vlerësimin mbi performancën e mësimdhënësit në anën tjetër nuk mund të dalin si duhet. Prandaj zhvillues të ndryshëm janë duke u marrë me ngritjen dhe trajtimin e kësaj dukurie, për të mbajtur në kontroll si dhe për të pas një pasqyrë mbi aktivitetin e përgjithshëm të procesit edukativo-arsimorë.

Programe të ndryshme që ndihmojnë këtë proces janë të shumtë. Po thuajse të gjithë zhvilluesit janë fokusuar edhe në pjesë e programeve për edukim individual (Individualized Education Program) të njohur si IEP. Ata që dallohet si programe më të avancuara për nga mundësitë dhe trajtimin e kategorive të veçanta⁴ (po i përmendim disa, sepse ka mjaft):

- *Skyward Students Management Suite*
- *PowerSchool Unified Classroom special Programs*
- *Frontline Special Education Management Software*
- *Uniques Learning System*

Secili nga aplikacionet e lartpërmendura janë profesionale dhe të dedikuara posaçërisht për trajtim të procesit edukativo-arsimorë me theks të veçantë për procese me të mësimin me nxënës me nevoja të veçanta.

⁴ Informata mbi programet e veçuara të marra nga www.g2.com qasja 13 shkurt 2021

Programet e tilla ndihmojnë nxënësit me aftësi të kufizuara për të arritur potencialin e tyre. IEP thjeshton punën me nxënësit që kanë çështje mësimore të shkaktuara nga dëmtime të trurit, vonesa në zhvillim ose paaftësi intelektuale. Përgjigja ndaj programeve të tilla ndërhyrëse sigurojnë mjetet e kërkuara edhe për vlerësimin e njohurive dhe arritjeve të nxënësve. Një zgjidhje e tillë ndihmon për të monitoruar progresin e të nxënit dhe për ta vizualizuar atë, gjithashtu, thjeshton trajtimin mbi grumbullimin e të dhënave, rrjedhimisht nxjerrjen e raporteve me anë të të cilëve, përveç pasqyrave mbi arritjet e nxënësve mundësohet edhe vlerësimi mbi performancën e mësimdhënësit.

Sipas vlerësimeve të universitetit të Cincinatit

KAPITULLI III

3.1. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është arritje deri te përgjigjet e pyetjeve përmes aplikimit të procedurave shkencore. Qëllimi kryesor i punimit është thjeshtësimi i të kuptuarit të perceptimit të mësimdhënësve mbi shfrytëzimin e teknologjive informative në procesin edukativo-arsimorë dhe vlefshmërisë mbi hipotezën që shkollat kosovare nuk janë krejtësisht të gatshme për një ndryshim të tillë.

E gjitha është realizuar përmes hulumtimit që ishte planifikuar të bëhet përmes mbledhjes së informatave nga respondentët mësimdhënës nga tërë territori i Kosovës. Sasia e mbledhur e të dhënave krijoi mundësi dhe nguliti mendimin shkencor duke promovuar zhvillim.

Studimi i literaturës ishte metoda e parë dhe më e thjeshta, por e frytshme për të formuluar saktësisht rrugëtimin e hulumtimit. Hipotezat e deklaruara mund të rishikohen dhe dobia e tyre të vlerësohet si bazë për hulumtime të mëtejshme. Në këtë mënyrë duhet të rishikojë dhe të bazoj punën e bërë tashmë nga të tjerët.

3.1.1. Metodatat e hulumtimit

Metodat e hulumtimit përbëhen nga teknikat dhe procedurat që janë përdorur për të marrë dhe analizuar të dhënat përkatëse nga mësimdhënës, derisa metodologjia është qasja e përgjithshme e cila mbështet procesin e hulumtimit (Blaxter, Hughes, & Tight, 2001). Në hartimin e hulumtimit, ekzistojnë dy metoda kryesore të kërkimit, këto janë kërkime cilësore dhe sasiore. Hulumtimi cilësor përfshin grumbullimin dhe përdorimin e informacionit nga studimi i rastit, intervistat, përvojën personale, ditarin, ndërveprimet, ndërsa metodat sasiore përfshijnë numra dhe analiza të matjeve që mund të zëvendësohen lehtësisht nga studiues të tjerë. Sipas (Myers, 1997) hulumtimi cilësor përfshin të dhëna cilësore që kanë lehtësuar kuptimin e dukurive sociale dhe ndërtimit social, ndërkohë që metoda kuantitative kategorizohet nga një metodologji e hipotezës që mund të testohet përmes eksperimenteve dhe analizës statistikore (Creswell, Hanson, Pano, & Morales, 2007).

Shqyrtimi i literaturave nga autorë të ndryshëm duke filluar nga vitet e 70-ta deri më 2020 është përpunuar duke përfshirë edhe raporte shtetërore, punime shkencore, publikime konferencash dhe libra të ndryshëm që trajtojnë ndryshime të procesit edukativo-arsimorë për

kategoritë e nxënësve me kërkesa të veçanta. Në këtë formë është ndërtuar koncepti teorik i problematikës mbi ndryshimet e realizuar gjatë katër dekadave të fundit.

Strategjia e hulumtimit si metoda më e përdorur për mbledhjen e të dhënave. (Bryman & Bell 2003) sugjeron se nuk ka strategji superiore ndaj të tjerave, por duhet të zgjidhet ajo që i përshtatet më mirë hulumtimit. Për qëllimin e këtij hulumtimi, pyetësi i bazuar në studim është përdorë për mbledhjen e të dhënave. Ky pyetësor ka 25 pyetje dhe iu është dërgohet respondentëve në mbarë territorin e Kosovës, disa në rrugë elektronike dhe disa gjatë takimeve individuale dhe bisedimeve rreth tezës së ngritur këtu.

Një pilot projekt fillimisht është dërguar tek disa respondentë për të testuar pyetësin dhe për të identifikuar dhe eliminuar problemet e mundshme përpara se të shfrytëzohet si burim primar për mbledhje të të dhënave.

3.1.2. Populacioni dhe mostra

Me ndërtimin e pyetësit pas shqyrtimit të literaturës, është realizuar shpërndarja e pyetësit në së paku 50 mësimdhënës nga pesë shkolla të mesme të larta në qytete të ndryshme të Kosovës. Republika e Kosovës ka mbi 5000 mësimdhënës në shkolla të mesme të larta dhe mbi 23,000 në nivel vendi (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019), derisa llogaritet që në të gjitha nivelet, janë rreth 6,000 nxënës me nevoja të veçanta. Pasi janë mbledhur të dhënat dhe janë analizuar rezultatet është bërë adaptimi dhe riformulim i pjesërishëm i pyetësit, dhe më pas është realizuar shpërndarja duke shfrytëzuar kryesisht rrugën elektronik, për të realizuar grumbullimin e përgjigjeve nga rreth 20% të mësimdhënësve të angazhuar në procesin edukativo-arsimorë në shkolla të mesme të larta në Kosovë.

3.2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Punime akademike dhe shkencore të shumtë të cilët trajtojnë problemet zhvillimore dhe integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në procesin e rregullt mësimorë e me theks të veçantë në kombinim me zhvillimet e TIK, tregojnë hezitimin e mësimdhënësve si refleks nga mungesa e përgatitjeve adekuate. Pyetësi me 25 pyetje, njëzet nga të cilat grumbullojnë informacion të rëndësishëm mbi kuptimin dhe nevojën për ndryshime nga mësimdhënësit dhe institucionet edukativo-arsimore, dhe pesë pyetje të drejt-për-drejta për matjen e perceptimit dhe përvojës së tyre është shfrytëzuar si element kyç për zërthimin dhe matjen e hipotezave të ngritura. Siç është praktikë e shteteve të zhvilluara për ngritje eksperimentale këtu

kuptojmë gjithashtu me anë të përpunimit të përgjigjeve të grumbulluara se mësimi eksperimental është procesi i krijimit të njohurive përmes transformimit të përvojës dhe natyrshëm të adoptuar në shumë fusha të ndryshme, padyshim edhe në procesin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies duke përfshi edhe kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta.

Për qëllimin e ndërtimit të punimit, janë shfrytëzuar burime të ndryshme primare dhe sekondare, duke shfrytëzuar publikime në revista shkencore, konferenca, raporte dhe libra e simpoziume të ndryshme që shqyrtojnë teknologjinë informative si pjesë e ndryshimit të procesit të të mësuarit për kategoritë e veçanta të shoqërisë. Në anën tjetër si burim primar i mbledhjes së të dhënave për hartimin e punimit, kemi ndërtuar pyetësin që është shpërndarë në forma të ndryshme për të mbledh të dhënat nga respondentë mësimdhënës, nxënës, prindër dhe administratorë të institucioneve edukativo arsimore, si dhe janë bërë krahasime me punime shkencore dhe të tjera që trajtojnë problematikë të ngjashme.

Pyetëtorët janë shpërndarë në mënyrë të rastësishme në shkollat kosovare, duke synuar marrjen e informacionit nga rreth 20% e mësimdhënësve nga shkollat e mesme të larta Kosovë. Të dhënat nga hulumtim iu nënshtruan procesit analitik për statistikat përshkruese ashtu edhe për diferencialë duke përdorur softuerin SPSS. Nga të cilat rezultatet tregohet se integrimi i TIK-ut ka një efektivitet të madh si për mësimdhënësit ashtu edhe për vet nxënësit me nevoja të veçanta. Të gjeturat tregojnë se përgatitja dhe pajisja adekuate me TIK e mësimdhënësve është një nga faktorët kryesorë në suksesin e mësimdhënies dhe mësimin të bazuar në teknologji. Gjithashtu supozohet që programet e trajnimit për zhvillim profesional për mësimdhënësit luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e të mësuarit cilësor të nxënësve.

Për hulumtime të mëtutjeshme, duhet të merren parasysh aspektet e tjera të integritetit të TIK-ut, veçanërisht nga pikëpamja e menaxhimit në lidhje me planifikimin strategjik dhe hartimin e politikave, me qenë se nuk përfshihen të njëjtat në këtë punim.

3.3. METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT

Në përpjekje për të gjetur çdo studim që mund të plotësonte kriteret e përfshirjes, është bërë një kërkim i literaturave të artikujve të shkruar midis viteve 1980 dhe 2020.

Përhapja e teknologjisë, posaçërisht në procesin mësimorë për kategori me kërkesa speciale, e sidomos në fillim vitin kalendarit të 2020-s, dhe kërkesa për informacion të azhurnuar vazhdimisht e nevoja që njerëzit të kenë qasje në informacion kudo, pa

anashkaluar dhe individualizimin e procesit edukativo-arsimorë kanë çuar në pedestal shfaqjen e arsimit në distancë, mësimin elektronik përfshirë edhe të mësuarit me telefon, që në vetvete është sfidë për procesin, posaçërisht për kategorinë e nxënësve me kërkesa të veçanta, është realizuar në disa vende të zhvilluara. Tani kur ekziston një garë kundër kohës, teknologjia nuk është më vetëm një mjet komunikimi, por ajo ofron qasje të lehtë në informacione të pakufizuara në çdo kohë dhe nga çdo vend në fushën e arsimit me zhvillimet teknologjive të ndryshme.

3.4. DEFINIMI I PROBLEMIT, QËLLIMI I HULUMTIMIT, PYETJET DHE HIPOTEZA E HULUMTIMIT

Teoria që thekson vlerën e veprimit gjatë mësimin *'të mësosh duke e bërë'*. Nga një këndvështrim i të mësuarit përmes zhvillimit, mësimi është një proces në të cilin krijohen njohuritë përmes përvojës transformuese (Kagan, 1999). Mësimi optimal ndodh kur njerëzit janë në gjendje të lidhin përvojën e kaluar me konceptet e reja që ata duan të mësojnë.

Mësimi eksperimental përdor aktivitetin e të mësuarit në të cilin nxënësit me kërkesa të veçanta hasin kontekste të prekshme të të mësuarit (Pimentel, 1999), dhe vazhdon edhe sot mësimi eksperimental siç është aplikuar edhe në fusha tjera.

KAPITULLI IV

Kapitulli IV pasqyron në formë analitike dhe përshkruese rezultatin nga përgjigjet e grumbulluara përmes pyetësorit dhe jep vlerësime të matshme dhe drejtim për ndryshime të nevojshme në procesin edukativo-arsimorë si për nga nevoja e investimeve në institucione, si për nga nevoja e zhvillimeve të teknologjive të reja, por më e rëndësishmja për krijimin e mundësive zhvillimore për mësimdhënësit dhe hapësirave për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në procese të natyrshme mësimore dhe zhvillim personal.

4.1. REZULTATET E ARRITURA TË HULUMTIMIT

Pyetësi është shpërnda në sasi të mjaftueshme për të analizuar rezultatet nga përgjigjet e pranuar dhe testuar hipotezat e ngritura duke vë në pah problematikën e paraqitur rreth perceptimit të mësimdhënësve dhe përfshirjes së teknologjisë informative në kombinim me mësimin special me nxënës me nevoja të veçanta.

Është interesant fakti që gjatë plotësimit të pyetësorëve disa nga respondentët që gjetën kohën dhe dhanë kontributin e tyre, krijojnë lidhshmëri jo vetëm me kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta por edhe me procesin e përgjithshëm edukativo-arsimorë në nivel vendi, që sipas tyre kërkon reformim të thellë dhe padyshim përfshirjen e teknologjisë informative si vegël e detyrueshme në fusha të caktuara dhe si vegël e dëshirueshme në pjesën tjetër të procesit.



Figura 1 Ilustrim i nxënësës me karrocë për lëvizje në ambientë shkollorë (marrë nga interneti)

Ishte vështirë dhe njëherit kënaqësi që pata rastin të takoj kolegë nga mbarë vendi gjatë rrugëtimit për plotësimin e sa më shumë pyetësorëve dhe të mësoj rreth problemeve me të cilat ballafaqohet mësimi kosovarë. Rezultatet që janë nxjerrë nga pyetësorët janë analizuar me programin statistikorë SPSS versionin 2.6 me anë të të cilit është arritur të konfirmohen të tre hipotezat e ngritura. Me qenë se jam vet e angazhuar dhe bëj pjesë në mësimdhënie dhe kam informacion të bollshëm me atë që është duke ndodh me arsimin kosovarë si dhe me kategoritë e nxënësve me nevoja të veçanta, konsideroj që rezultatet e arritura nga hulumtimi nuk paraqesin befasi. Ajo që tregojnë rezultatet nga ky hulumtim, është mbështetja - me rezerva - e pjesërishme e formës së kalimit nga procesi i të mësuarit tradicional në atë të bazuar me plotësisht në TIK, duke i lënë hapësirë kohës për zhvillime të mëtutjeshme teknologjike dhe ndërtim në infrastrukturë për përfshirja sa më të plotë të nxënësve me nevoja veçanta dhe përvetësimi të njohurive dhe zbatueshmërisë së TIK-ut nga mësimdhënësit në mënyrë të pavarur.

Viti që lamë pas dhe ky aktual e ka dëshmuar zhvillimet e teknologjisë informative dhe të komunikimi nga distanca janë të gatshme për shfrytëzim në procesin edukativo-arsimorë, po aq sa ka dëshmuar që ne përkundër që i kemi mjetet me të cilat mund ta shndërrojmë mësimin tradicional në diçka më shumë, jeni ne ata që nuk jemi të gatshëm. Konsiderohet që perceptimi i mësimdhënësve do mund ta forcoj zbatueshmërinë e ndryshimeve në plotësimin e mësimin tradicional në atë të kombinuar me TIK në përgjithësi, e në veçanti, por me sfida dalluese duke iu përshtat kategorive të ndryshme të nevojave që paraqesin nxënësit të cilët kërkojnë trajtim të veçantë apo mësim special. Pyetësi ishte hartuar në mënyrë të tillë që me pjesën e parë të pyetjeve të grumbulloj informacione rreth respondentëve, përkatësisht rreth gjinisë, përvojës, njohurive të caktuara për kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta dhe trajtimet e nevojshme speciale, për të kaluar me pyetje rreth njohurive të problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria dhe njohjes me llojet e kufizimeve që nxënësit mund të kenë, por edhe për dallimet dhe perceptimet e mësimdhënësve rreth dallimit të problemeve të zakonshme që paraqesin nxënësit me realisht nevojat e veçanta.

MASHT⁵ ka pas të hartuar plan strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore ne arsimin para universitar në Kosovë për vitet 2016-2021, planin e hartuar në vitin 2015 e ka vendos diku në sirtarë qeveritarë dhe nuk ka zhvilluar dinamikë për ta vë në punë, megjithatë, si dokument ka shërbyer studiuesve që të

⁵ <https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/plani-strategjik-per-gjitheperfsirjen-e-nxenesve-me-nevoja-te-vecanta-2016-2021.pdf>

orientohen për të trajtuar çështje të cilat ne si pjesë e procesit edukativo-arsimorë konsiderojmë të veçantë.

Analizën e rezultateve të cilën e shikojmë në vazhdim të kapitullit tre e kemi zbërthyer duke paraqitur grafikone dhe tabela për të vizualizuar rezultatet e nxjerra nga përgjigjet e grumbulluara dhe paraqitur gjendjen në formë më të përshtatshme për lexim dhe natyrisht për të lehtësuar shkollarëve në hulumtimet tjera të kësaj natyre.

Gjatë punës për ndërtimin e këtij dokumenti dhe hartimin e pyetësorit në veçanti është kuptuar që nevojat e veçanta me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe familjarët e tyre janë të shumta dhe dallojnë shumë nga njëra tjetra. Ilustrimi në vijim tregon se si në një hapësirë shkollore kemi dallime të mëdha të cilave si mësimdhënës por edhe si institucion duhet ti japim vëmendjen e duhur



Figura 2 dallimet e nxënësve me nevoja të veçanta

Figura 2 paraqet pesë individ të cilët ballafaqohen me probleme të caktuara të cilat kërkojnë trajtime të veçanta e që jo domosdoshmërisht janë të identifikuar si nxënës me nevoja të veçanta. Ky fakt me të cilin ballafaqohemi çdo ditë në institucione edukativo-arsimore dhe të tjera të destinuara për zhvillime të tilla, e bëjnë edhe më të lehtë kuptimin e çështjes së trajtimit special në hapësira të dedikuara. Konsiderohet, që në raste shumë specifike ndarja është mjeti i duhur, por në shumicën e rasteve, dhe siç paraqesin analizat e rezultateve gjithëpërfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në hapësira dhe procese të rregullta mësimnxënje janë më frytdhënëse e posaçërisht nëse ato kombinohen me përfshirjen e TIK.

4.2. ANALIZA E REZULTATEVE

Paraqitja e rezultateve dhe analiza e tyre e cila është bërë me programin statistikore SPSS versioni 2.6)

Për qëllimin e grumbullimit të të dhënave është hartuar pyetësori me gjithsej 25 pyetje dhe iu është shpërnda 970 individëve të angazhuar në institucione edukativo-arsimore të ndryshme në territorin e Republikës së Kosovë. Nga 970 pyetësorë 370 janë shpërndarë fizikisht dhe janë mbledhë informatat menjëherë pas plotësimit ndërsa 600 të tjera janë adresuar në rrugë elektronike prej të cilëve 105 ishin të plotësuar në masë nën 25% dhe si të tillë nuk janë trajtuar fare, derisa 495 respondentë kishin plotësuar mbi 98% të pyetësorit. Pra nga gjithsej 970 pyetësorë janë grumbulluar rezultate nga 865 respondentë, rezultate e të cilave tregojnë dhe japin sqarimet nëse hipotezat e paraqitura pranohen ose jo duke krijuar kështu mundësinë që të shikohet si është gjendja me trajtimin e kategorive të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe cilat janë perceptimet e të angazhuarve - duke shti në ekuacion edhe teknologjinë informative - me këtë dukuri.

4.2.1. Paraqitja e rezultateve nga pyetësori

Që të kemi një pasqyrim mbi respondentët kemi grumbulluar gjithashtu disa informata personale që ta kemi mundësinë e ndarjes së perceptimit të bazuar edhe nga përvoja dhe tipare të tjera çoftë tani apo për hulumtime të mëtutjeshme.




Figura 3 Ndarja sipas gjinisë së respondentëve

Sipas paraqitjet gjinore rezulton që pyetësorit i janë përgjigjur pozitivisht 495 pjesëmarrëse femra dhe 370 meshkuj. Respondentët ishin të moshave të ndryshme,

përgjithësisht ishin si në vijim: nga mosha 20 deri 30, 147 respondentë, nga mosha 31-40, 365 respondentë, mes moshës 1 dhe 50 ishin 255 respondentë dhe mbi 50 vjeçarë ishin 98 respondentë.

Përkundër përshtypjeve të shumta që mosha e stafit akademik dhe të tjerëve është mjaft e shtyrë, nëse bazohemi në këtë hulumtim rezulton që pjesa dërmuese e stafit në institucionet e arsimit Kosovare janë mes moshës 31 dhe 40 apo rreth 42% dhe mes moshës 41 dhe 50 janë 29%. Natyrisht që këta numra nuk paraqesin mesataren e përgjithshme mbi moshën e të angazhuarve në institucione edukativo-arsimore, por gjithsesi janë indikacione relativisht pozitive.

Në anën tjetër angazhimet e respondentëve në sistemin edukativo-arsimorë është pak-a-shumë në të njëjtën trase duke shikuar përvojën e tyre të punës. Në pyetjen: *”Duke llogaritur vitin aktual (përfshirë edhe punën me orar të shkurtuar) sa vite keni që jeni duke punuar në institucione edukativo-arsimore?”* përgjigjet e të cilëve janë paraqitur në figurën e radhës.




Figura 4 pasqyra e përvojës vjeçare e respondentëve pjesëmarrës

Tregues shqetësues ishte rezultati nga pyetja #4 e pyetësorët në të cilën shihet qartë që shumica e stafit mësimdhënës nuk ballafaqohet me fëmijë (nxënës) me nevoja të veçanta – apo edhe më keq nuk identifikojnë pa-aftësi të tilla tek nxënësit me të cilët punojnë. Nga pyetja #4: *“Duke llogaritur vitin aktual (përfshirë edhe punën me orar të shkurtuar) sa vite*

keni që jeni duke punuar me nxënës me nevoja të veçanta apo diçka të ngjashme që lidhet me këtë proces?” ishte qëllimi që të mësojmë sa nga stafi i angazhuar në institucione edukativo-arsimore ballafaqohet me kategori të nxënësve me nevoja të veçanta, e gjithë kjo për të i “zhytur” në problematikën të cilën përmes këtij punimi dëshirojmë ta arrijmë.




Figura 5 numri i stafit edukativo-arsimorë që punon me nxënës me aftësi të kufizuara

Siç mund ta shikoni, figura 3 paraqet numra jo-normalisht të ulët të stafit të angazhuar në institucione edukativo-arsimore që punojnë me nxënës që kanë nevoja të kufizuara dhe kërkojnë në rastet më të rënda trajtim special. Në anën tjetër nga gjithsej 895 respondentë 714 apo 82.54% e tyre kanë deklaruar që nuk kanë punuar asnjëherë me nxënës me nevoja të veçanta - në raste të izoluar ka pas reagime të tilla që nuk do të pranoheshin sepse iu mungon përvoja e duhur - ndërsa 89 respondentë apo 10.29% nuk janë përgjegjës fare. Rezultatet e të angazhuarve që punojnë - ose që kanë punuar - me nxënës me nevoja të veçanta në raste të izoluar nuk janë paraqitur fare, por ajo që tregon një rrugëtim të vazhdueshëm është që 37 respondentë apo 4.28 nga respondentët punojnë në vazhdimësi me numër mjaft të lartë të nxënësve me nevoja të veçanta. Vlen të theksohet që kjo është pjesë e izoluar dhe nuk përfshijnë shtrirje në gjithë territorin, ndërsa 16 nga respondentët apo 1.85% e respondentëve merren aktivisht me këtë kategori.

Për të kuptuar më mirë trajtimin e kësaj çështjeje të ndjeshme gjatë diskutimit të literaturës, bashkëbisedimit me kolegë të fushës dhe punës me forma të tjera, kam vlerësua që është me rëndësi të veçantë me e kuptua si e trajtojnë detyrën të angazhuarit në institucione

edukativo-arsimore, prandaj pyetja #5 “Si e klasifikoni detyrën tuaj (cili është aktiviteti i juaj ditorë) në institucionin ku jeni të angazhuar?” ishte qëllimisht e vendosur në formën e mbyllur me pesë plus një alternative duke kërkuar që secili respondentë të kategorizoj detyrën e tij/saj.

Nga kjo pyetje kemi kuptuar që 97.68% janë mësimdhënës me orar të plotë, 0.46% janë mësimdhënës me orar të pjesërishtëm, 1.39% janë mësimdhënës me orar të plotë në por të angazhuar në më shumë se një institucion, 3.47% janë mësimdhënës zëvendësues dhe asnjë nuk merr pjesë në cilësimet e mësimdhënësit ndihmës apo ndonjë kategorie tjetër. Për më tepër rezultati i përgjigjeve të pyetjes #6 “A posedoni licencë speciale për ushtrimin e detyrës tuaj me nxënës me nevoja të veçanta, nëse po, cili autoritet e ka leshu licencën?” rezultojnë që asnjë nga 865 respondentët nuk janë të pajisur me licencë specifike që dëshmon apo krijon mundësinë e thirrjeve speciale për trajtimin dhe integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

Derisa pyetja e radhës #7 “Sa kurse keni përfunduar në fushat e poshtëshënuara?” duke renditur trembëdhjetë lloje të kurseve që ofrohen nga vendorë të ndryshëm qoftë në Kosovë apo jashtë vendit janë dalin si tregues të përgjithshëm mbi vazhdimësinë e arritjeve akademike dhe profesionale të cilat i shikojmë të nxjerra nga programi statistikorë sipas rezultateve të pyetësorit.

Tabela 1 Lloji dhe kurset mbajtura nga respondentët

Posterior Distribution Characterization for One-Sample Mean

	N	Mode	Posterior		95% Credible Interval	
			Mean	Variance	Lower Bound	Upper Bound
Edukimi special për fëmijëri të hershme	3
Edukate elementare	824	.0352	.0352	.002	-.0614	.1318
Edukimi dygjuhësh	265	.2642	.2642	.011	.0556	.4727
Edukimi special i përgjithshëm	440	.6477	.6477	.009	.4609	.8346
Pamundësi për të mësuar	4
Prapambetja mendore	24	.0833	.0833	.250	-.8966	1.0633
Dëmtime ortopedike	0
Çrregullim serioz emocional	4
Shurdhim dhe dëgjim i dobët	32	.0313	.0313	.281	-1.0082	1.0707
Verbëria dhe probleme me shikimi	16	.3125	.3125	.625	-1.2370	1.8620
Çrregullimet e komunikimit	15
Psikologji shkollore	333	.1231	.1231	.036	-.2489	.4952
Menaxhimi i klasës	322	.6242	.6242	.040	.2304	1.0180

Prior on Variance: Diffuse. Prior on Mean: Diffuse.

Siç vërehet nga tabela 1 pjesëmarrja e respondentëve të angazhuar në institucione edukativo-arsimore në kurse të ndryshme është evidente. Kursi më i frekuentuar me 824 *variance* e së cilës është .002 dhe devijimi standard -.0614 respondentë ishte kursi për edukatë elementare, ndërsa kursi në të cilin asnjë respondentë nuk kishte marrë pjesë ishte për ai dëmtime ortopedike. Menaxhimi i klasës për të cilin kishte pritshmëri më të lartë pati vetë 322 respondentë prej tyre apo 37.23% prej tyre kishin marrë këtë kurs një herë 165 respondentë, kanë përsëritur dy herë 114 respondentë dhe 43 kanë marrë pjesë 3 herë në po të njëjtin kurs. Po ashtu nga gjithsej 440 apo 50.87% të respondentëve që kanë ndjekur kursin “Edukimi Special i përgjithshëm” 214 apo 24.74% kanë ndjekur një herë, 184 apo 21.27% kanë ndjekur dy herë të njëjtin kurs dhe 42 apo 4.86% të respondentëve kanë përsëritur të njëjtin kurs tri herë.

Dukuri e veçantë në ndjekjen e kurseve ishte që asnjë nga të angazhuarit në institucione edukativo-arsimore nuk kanë përsëritur asnjërin nga kurset e përshkuara më shumë se tre herë gjatë karrierës së tyre disa-vjeçare.

Me po të njëjta shënime nga rezultatet e përgjigjeve të grumbulluara nga pyetja #7, me paraqitjen e krahasimeve duke shfrytëzuar metodën One-Sample Test (testim me mostër) në programin statistikorë SPSS, shikojmë dallimet që dalin nga tabela paraprake.

Tabela 2 Testi model me më shumë se një të dhënë nga përgjigjet e grumbulluar mbi kurset e ndjekura

One-Sample Test

	t	Df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Lo wer	Upp er
Edukate elementare	5. 479	8 23	.000	.03519	.0 226	.047 8
Edukimi dygjuhësh	9. 735	2 64	.000	.26415	.2 107	.317 6
Edukimi special i përgjithshëm	2 0.631	4 39	.000	.64773	.5 860	.709 4
Prapambetja mendore	1. 446	2 3	.162	.08333	- .0359	.202 6
Shurdhim dhe dëgjim i dobët	1. 000	3 1	.325	.03125	- .0325	.095 0
Verbëria dhe probleme me shikimi	2. 611	1 5	.020	.31250	.0 574	.567 6
Psikologji shkollore	6. 477	3 32	.000	.12312	.0 857	.160 5
Menaxhimi i klasës	1 5.694	3 21	.000	.62422	.5 460	.702 5

Duke vlerësuar përgjigjet e grumbulluara vërehen dallime mes kurseve të cilat janë ndjekur nga respondentët vetë një herë siç është ‘Edukimi special për fëmijëri të hershme’, ‘Pamundësi për të mësuar’ dhe ‘Çrregullim serioz emocional’ apo të kurseve që nuk janë ndjekur nga asnjëri respondentë siç është kursi për ‘Dëmtime ortopedike’ të cilat janë të pakrahueshme në raportin e nxjerr me metodën me vetëm një mostër të paraqitur tek tabela #2. Ky faktor tregon që devijimi total me 823 poenë është kursi i preferuar i respondentëve - apo ndoshta i obliguar - me qenë se shumica dërmuese e respondentëve kanë ndjekur këtë kurs, përderisa kursin e parë devijimi statistikore është faktor tregues pozitiv pasi që diferenca ndikuese minimale 0.226 dhe ajo maksimale 0.478 janë relativisht të ulëta por rrjedhimisht edhe të pranueshme në aspektin statistikore. Në anë tjetër ku devijimet janë të theksuara si rrjedhojë e rezultateve të paraqitura në tabelën #2 i referohen dy kurseve, gjegjësisht ‘Prapambetja mendore’ dhe ‘Shurdhim dhe dëgjim i dobët’ ku diferencat e frekuentimit të ulët janë negative -0.359, respektivisht -0.325 derisa devijimi maksimal është .2026 dhe për kursin e dytë .0950 me çrastë ka përshkallëzim të theksuar dhe rrjedhimisht dhe teorikisht pozicioni i pa pranuar. Kursi menaxhimi i klasës i cili ishte një nga përgjigjet në të cilin pritej një përgjigje shumë më ndryshe, rezultojë mos të jetë ashtu. Megjithatë ky kurs ishte ndjekur 322 herë, respektivisht vetëm nga 165 respondentë apo thënë më saktësisht 12.95%. nga ta dy herë kanë ndjekë të njëjtin kurs dy herë 112 respondentë nga 165 dhe tre herë vetëm 43 respondentë apo 26.06% përsëritje, ndërsa vetë 4.97% nga 865 respondentë kanë ndjekë kursin Menaxhimi i Klasës.

Pyetja #8 kishte për qëllim nxjerrjen e ndjesisë dhe përgjegjësisë që kanë respondentët e angazhuar në institucione edukativo-arsimore. Pyetja “*Cila nga kategoritë e listuar përshkruan më së miri pozicionin tuaj në shkollë?*” ishte e ilustruar me përgjigje të mbyllura dhe jo domosdoshmërisht e kufizuar me një përgjigje dhe dolën rezultate intriguese.

Derisa pyetja e radhës paraqet në formë të theksuar pozitat që respondentët mbajnë në institucionet edukativo-arsimore, dhe siç shihet tek Aneksi 1 - pyetësi i shfrytëzuar - kemi paraqitur përgjigje të mbyllura dhe në programin statistikore kemi dhënë secilës alternative një ‘PO’ apo një ‘JO’ sipas përgjigjeve të marra dhe duke shfrytëzuar analiza kemi nxjerrë edhe përfundime të cilat i shikojmë në vijim:

Tabela 3 Roli i respondentëve në institucion

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Mësimdhënës i arsimit special	PO	14	1.6	1.6	1.6
	JO	851	98.4	98.4	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Konsulent i mësimdhënësve të arsimit special	PO	5	.6	.6	.6
	JO	860	99.4	99.4	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Mësimdhënës i arsimit të përgjithshëm	PO	827	95.6	95.6	95.6
	JO	38	4.4	4.4	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Terapist profesionist	PO	3	.3	.3	.3
	JO	862	99.7	99.7	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Psikologu shkollor	PO	16	1.8	1.8	1.8
	JO	849	98.2	98.2	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Ndihmësi i klasës së arsimit special	JO	865	100.0	100.0	100.0

Siç vërehet nga tabela me të gjitha rezultatet e pranuar nga respondentët për pyetjen në të cilën kemi ofruar gjashtë zgjedhje - përgjigje të mbyllura – në pesë nga to kemi marrë përgjigje pozitive. Megjithatë, është pasqyrë shumë e zbehtë pjesëmarrja e respondentëve drejtpërdrejtë në procesin e zhvillimit të procesit edukativo-arsimorë me nxënës me nevoja të veçanta. Siç shihet në tabelë vetëm 14 respondentë apo 1.6% e pjesëmarrësve në këtë pyetësorë merren drejtpërdrejtë me nxënës me nevoja të veçanta, dhe për më keq, nuk ka asnjë ndihmës që merret me këtë kategori të nxënësve. Në anën tjetër, 827 respondentë apo 95.6% e tyre janë të angazhuar si mësimdhënës të arsimit të përgjithshëm. Si psikolog u rreshtuan 16 respondentë apo 1.8%, si terapist profesional vetëm 3 respondentë, ndërsa konsulent për nxënës me nevoja të veçanta ishin rreshtuar pesë nga 865 respondentë apo vetëm 0.6%.

Duke e pa rëndësinë edhe të hapësirave ku normalisht punojnë nxënësit ishte e nevojshme që të kuptohet se sa ka kufizime apo lehtësira në këtë drejtim, prandaj pyetja e radhës “Gjatë vitit akademik, ku keni punuar me nxënësit me nevoja të veçanta?” tregon tutje

brishtësinë e angazhimit të personelit akademik dhe të tjerëve që nuk bëhet sa është e nevojshme për kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta:

Tabela 4 Ku punoni me nxënës me nevoja të veçanta

		Fre quency	P ercent	Va lid Percent	Cumul ative Percent
Në klasë për edukim të përgjithshëm	PO	44	5.1	5.1	5.1
	JO	821	94.9	94.9	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Në klasë për edukim special	PO	22	2.5	2.5	2.5
	JO	843	97.5	97.5	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Në hapësira jo klasore (zyre apo të ngjashme)	PO	6	.7	.7	.7
	JO	859	99.3	99.3	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Tjetër	PO	2	.2	.2	.2
	JO	863	99.8	99.8	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Nuk punoj drejtpërdrejtë me nxënës me nevoja të veçanta	PO	794	91.8	91.8	91.8
	JO	71	8.2	8.2	100.0
	Total	865	100.0	100.0	

Me paraqitjen e rezultateve në tabelën e sipërme, plotësohet tutje këndvështrimi i neglizhencës ndaj nevojës për trajtim ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta, gjithsesi, tregohen entuziastë që ofrohen me ide kreative dhe ndihmojnë me aq sa munden. Dy nga respondentët dhanë përgjigje të hapur duke elaboruar trajtimin e nxënësve të cilët i kanë përcjellë gjatë karrierës së tyre. Një nga opsionet e përgjigjeve ishte që të specifikohet mënyra si është vepruar me punën e tyre në raportin e vendin apo thënë ndryshe përzgjedhjes së trajtimin në hapësira të tjera pune. Një nga respondentë kishte zgjedhë laboratorin e teknologjisë informative për punë me nxënës me nevoja të veçanta duke shfrytëzuar resurset që i kishte në dispozicion, ndërsa respondenti i dytë që kishte zgjedhur opsion *tjetër*, kishte specifikuar trajtimin e punës në hapësira gjelbëruese ku ka frekuentim të ulët të personave. Në anën tjetër përmes përgjigjeve nga kjo pyetje u kuptua që në disa institucione ka dhoma speciale për punë me nxënës me nevoja të veçanta, këtë e konfirmojnë 22 respondentë apo 2.5% e pjesëmarrësve në pyetësorë. Natyrisht një pjesë e respondentëve, respektivisht 5.1% apo 44 nga 865 e shfrytëzojnë klasën për mësim të përgjithshëm edhe me rastet kur kanë nxënës me nevoja të veçanta, një numër shumë më i vogël shfrytëzon kabinete apo zyre 0.7% e tyre përkatësisht, dhe pjesa dërmuese e respondentëve, pra mbi 90% apo rreth 800 të angazhuar në institucione edukativo-arsimore nuk punojnë apo nuk kanë punuar asnjëherë me nxënës me nevoja të veçanta.

Për të nxjerrë thellësisht më shumë informacion mbi angazhimin e respondentëve me fëmijë me nevoja të veçanta kemi ndërtuar edhe pyetjen e radhës “Gjatë vitit akademik, me sa fëmijë me nevoja të veçanta keni punuar (mesatarisht gjatë një jave)?” po ashtu me qëllim që të kuptojmë rreth numrit të nxënësve me nevoja të veçanta që frekuentojnë institucionet edukativo-arsimore, rezultatet në vijim:




Figura 6 Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në klasë

Në diskutim e sipër gjatë plotësimit të pyetësorëve me respondentë, shumica e atyre që plotësonin përgjigjen e kësaj pyetje, deklarorin që nuk kanë punuar me më shumë se 1 nxënës me nevoja të veçanta në të njëjtën kohë dhe që kanë has në vështirësi si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve adekuate për mësim me nxënës që kanë nevoja apo trajtim special. Gjithsesi, përgjigje në këtë pyetje ka pas nga vetëm 51 respondentë apo 5.9% nga 865 sa ishin në tërësi.

Në anën tjetër me pyetjen e radhës, kemi kërkuar nga respondentët që të identifikojnë aftësinë e kufizuar apo nevojën e veçantë të nxënësve me të cilët kanë punuar, dhe rezultatet statistikore i paraqesim me tabelën e radhës.

Tabela 5 cila është aftësia (kyçe) e kufizuar e nxënësve me të cilët jeni apo keni punuar?

Statistics		
	Vali	Mis
	d	sing
Paaftësia e të mësuarit	410	0
Çrregullim serioz emocional	14	396
Çrregullim i të folurit (gjuhës)	22	388
Prapambetja mendore	3	407
Verbëri apo shikim të dobët	2	408
Shurdhë-memec	3	407
Çrregullim fizik	7	403
Vonesa në zhvillim	18	392
Autizëm	25	385
Lëndimi traumatik i trurit	4	406

Siç mund të shihet shumë nga përgjigjet nuk mund të konsiderohet të numra të cilët tregojnë rezultate të sakta. Nga 865 respondentë me përjashtim të tre pyetësorëve, respondentët kishin zgjedhë vetën një përgjigje, qe rezulton me 505 përgjigje të plotësuar apo rreth 58%. Ky rezultat natyrisht, bie ndesh me përgjigjet e pranuar nga pyetjet paraprake dhe tregon që nuk ka sinçeritet të plotë mbi pyetësorin, apo nuk është mjaftueshëm e qartë për respondentët çka nënkupton nxënësi me nevoja të veçanta. E gjithë kjo bazuar në përzgjedhjen 410 përgjigjeve për *paaftësi e të mësuarit* të cilën e plotësuar mbi 47% nga 865 respondentë. Mësim-nxënia sipas përgjigjes krijon përshtypje që është ngatërruar me kufizimin e aftësive të disa nxënësve që realisht kanë nevoja të veçanta, apo mungesa e informimit adekuat për të angazhuarit në institucione edukativo-arsimore krijon një përshtypje të tillë.

Pyetja “*Cila nga programet për edukim special përshinë më së miri objektiven e institucionit ku jeni i angazhuar?*” e radhës intrigon respondentët dhe ngrit kureshtjen për të u kyçur në trajtimin e problematikës dhe pikërisht duke u përgjigjur në këtë pjesë hapen diskutime për çështjet që realisht i ka institucioni apo që duhet të ketë dhe ato që lidhin vet respondentëve me vlerat e tyre që ata ia japin nxënësve - jo vetëm atyre me nevoja të veçanta - në përgjithësi.

Tabela 6 devijimi standart në pjesëmarrjen e përgjigjeve nga pyetje 12 e pyetësorit

		Statistics				
		Akademia	Të folurit dhe gjuha	Socializimi	Aftësi jetësore	Tjeter
N	Valid	865	865	865	865	3
	Missing	0	0	0	0	862
Mean		.7306	1.9503	.3618	.6844	.0000
Std. Deviation		.69074	1.02450	.73735	.46503	.00000
Percentiles	25	.0000	2.0000	.0000	.0000	.0000
	50	1.0000	2.0000	.0000	1.0000	.0000
	75	1.0000	2.0000	.0000	1.0000	.0000

Siç vërehet në tabelën më lartë, në aspektin statistikorë të gjitha alternativat e paraqitura në pyetësorë janë konsideruar dhe janë plotësuar sipas vlerësimeve individuale duke mos lënë asgjë të hapur, si dhe janë ofruar nga tre respondentë edhe alternativa që nuk ishin të përfshira në përgjigjet e listuara, për më shumë detale shikojmë rezultatet në tabelën e radhës.

Tabela 7 Përshinë e programe në përputhje me objektiven e institucionit ku jeni i angazhuar

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Akademia	Leximi	354	40.9	40.9	40.9
	Matematika	390	45.1	45.1	86.0
	Arti	121	14.0	14.0	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Të folurit dhe gjuha	Përpunimi dëgjimorë	108	12.5	12.5	12.5
	Të kuptuarit	67	7.7	7.7	20.2
	Të shprehurit	535	61.8	61.8	82.1
	Artikulimi i zërit/fjalës	70	8.1	8.1	90.2
	Pragmatika gjuhësore	85	9.8	9.8	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
	Socializimi	Socializimi	687	79.4	79.4
Komunikimi Masiv		43	5.0	5.0	84.4
Vendbanimi		135	15.6	15.6	100.0
Total		865	100.0	100.0	
Aftësimi jetësor	Adaptimi	273	31.6	31.6	31.6
	Pavarësimi	592	68.4	68.4	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Tjeter	Specifiko	3	.3	100.0	100.0
Missing	System	862	99.7		
Total		865	100.0		

Rezultatet e paraqitura në këtë tabelë tregojnë pozitivitet dhe qëndrueshmëri për institucionet dhe objektivat që drejtojnë personelin akademik. Nëse shikojmë pjesën e parë, fokusi akademik është relativisht bukur i shpërndarë mes leximit 40.9% dhe matematikës 45.1% dhe pjesën e artit me 14%. Rezultat që krijon përshtypje pozitive, natyrisht duke relativizuar Artin si pjesë integrale të leximit dhe matematikës, pasi që të dyja fushat lidhet në një formë apo tjetër me artin. Pjesa e dytë ishte me theks më të veçantë e fokusuar në trajtimin e tezës për çështjen e nxënësve me nevoja të veçanta dhe klasifikimit të drejtimit objektiv të institucionit, ku secila përgjigje u plotësua me kureshtje të shtuar, ku *Përpunimi dëgjimorë* nga 108 respondentë apo 12.5%, *Të kuptuarit* nga 67 respondentë apo 7.7%, derisa u veçua të *shprehurit* nga 535 apo 61.8% e respondentëve, duke vazhduar me 70 respondentë apo 8.1% për *Artikulimi i zërit/fjalës* dhe krejt në fund 85 respondentë apo rreth 10% e tyre vlerësuan *Pragmatikën gjuhësore* si tiparë që merret në kuadër të objektivës së institucionit edukativo-arsimorë në të cilin janë të angazhuar. Natyrisht, pjesë e radhë përfshin po ashtu si nxënësit me nevoja të veçanta edhe pjesën tjetër të nxënësve, marrë parasysh tani më socializmi është pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe siç paraqitet në tabelë 79.4% apo 687 nga 865 respondentë e konsiderojnë si pjesë e objektivës institucionale, përderisa 5% apo 43 respondentë e vlerësojnë si pjesë e objektivës komunikimin masiv dhe siç ishte pritur një pjesë e konsiderueshme merret edhe me aspektin demografik, respektivisht me vendbanimin ku 15.6% e respondentëve e vlerësojnë që kjo dukuri përfshihet në objektivat e trajtimit nga institucioni ku janë të angazhuar. Vlen të theksohet që shumica e atyre 135 respondentëve janë pjesë e cila ballafaqohen në baza ditore edhe vetë me udhëtime. Pjesë interesante është edhe pjesa e parafundit e kësaj tabelë, ku paraqiten rezultatet e pyetjes alternative që ka të bëjë me aftësimin jetësorë, të adaptohem dhe apo të pavarësohem. Alternativat natyrisht janë paksa kontradiktore, megjithatë japin pasqyrë si shikohet nga të angazhuarit në institucione edukativo-arsimore dhe për aq sa është e mundur bëhet lidhshmëria me objektivat institucionale. Gjithsesi, nga 865 respondentë 273 apo 31.6% vlerësojnë që adaptimi është diçka që konsiderohet në aspektin objektiv institucional dhe 592 respondentë apo 68.4% konsiderojnë që pavarësia është dhe duhet të jetë pjesë e objektivave zhvillimore institucionale për secilin individ e posaçërisht për nxënësit me nevoja të veçanta. Dallim i theksuar ishte tek kategoria e fundit ku tre nga 865 respondentë dhanë përgjigje alternative të hapur, dy nga ta e ilustruan përgjigjen në kombinim me lojëra dhe një e nga respondentët e përçoj tek muzika. Sipas informatave të pranuar nga kjo kategori, rezulton që ndikim shumë pozitiv ka loja posaçërisht për fëmijët disleksitë, ndërsa ata që ballafaqohen me autizëm dhe

probleme të ngjashme trajtimin më të mirë e pranojnë duke kombinuar melodi muzikore dhe përfshirje në përcjelljen e muzikës nga nxënësit me nevoja të veçanta.

Në theks të veçantë edhe pse jo i bazuar në numra statistikorë, rezulton që lojërat dhe muzika kanë rol të rëndësishëm në trajtimet që bëhen me nxënës me nevoja të veçanta, e në veçanti në kombinohen këto dyja në ambient shkollor.

Rreth orëve javore që ngarkohen institucionet për qasje me nxënës me nevoja të veçanta dhe adresim për trajtimin e punës me atë kategori të nxënësve, në përgjigjen e pyetjes *“Përafërsisht sa orë në javë edukim special i drejtpërdrejtë dhe shërbimeve të lidhura me të (domethënë, shërbimi i ofruar direkt fëmijës, nga mësimdhënësi apo specializant i një fushe të caktuar) është e planifikuar të i ofrohet nxënësve gjatë vitit shkollor?”* kemi arrite të marrim numra jo-relativisht të pritshëm, duke pas në konsideratë trajtimin që e kërkojnë nxënësin me nevoja të veçanta. Orët më të ulëta javore që janë evidentuar ishin 6 orë mësimore, ndërsa më e larta ishte 18 orë. Në mesatare të përgjithshme rezulton që orë mësimore me nxënës me nevoja të veçanta në nivel vendi organizohet 8 orë pune në javë për trajtim special. Ky numër natyrisht është i limituar dhe nuk i përket të gjitha institucioneve që respondentët përfaqësojnë. Përgjigje në këtë pyetje kanë ofruar 244 respondentë apo rreth 28% të kontribuuesve të këtij punimi.

Lidhshmëria e pyetjes paraprake nuk korrespondon në mënyrë eksplicite me pjesën e dytë të të njëjtës pyetje e cila kërkon që të jepet mendimi duke e interpretuar në përqindje aktivitetin e mësimit të përgjithshëm për nxënësit me nevoja të veçanta të cilëve iu ofrohet mësim apo trajtim i mësimit special, si rrjedhojë përgjigjet në pyetjen *“Përafërsisht sa (në përqindje) e orëve totale në shkollë nxënësve me nevoja të veçanta iu ofrohet arsim special dhe shërbime të lidhura me to jashtë klasë së arsimit të përgjithshëm, por brenda mjedisit shkollor?”* i janë përgjigjur të gjithë respondentët edhe pse jo të gjithë janë të kyçur në proces të mësimit ku ka trajtim special apo nxënës me nevoja të veçanta që kërkon trajtim special.

Tabela 8 Trajtimi special në procesin e rregullt të mësimit klasorë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	0	351	40.6	40.6	40.6
	1-10	222	25.7	25.7	66.2
	11-25	169	19.5	19.5	85.8
	26-50	83	9.6	9.6	95.4
	51-75	22	2.5	2.5	97.9
	76-99	18	2.1	2.1	100.0
	Total	865	100.0	100.0	

Natyrisht, vlera zero në përgjigjen e kërkuar nga kjo pyetje kishte mbi 40% të respondentëve, ndërsa vlera më e lartë kishte vetëm 2.1% apo vetëm 18 nga 865 respondentë vlerësuan lartësinë e trajtimit special çoftë për shkaqe mësimore, edukative apo të tjera aktivitete që ndërlidhin këtë çështje brenda hapësirave shkollore. Interesante dhe intriguese njëkohësisht ishte vlerësimi i trajtimit në lartësi nga 11% deri në 25% nga 169 respondentë të cilët përbëjnë rreth 20% të totalit të respondentëve, me çrrestë jep përshtypje që edhe rastet të cilat nuk identifikohen si nevoja të veçanta ato konsiderohen nga një pjesë e të angazhuarve në institucionet edukativo-arsimore si e tillë!

Pyetja 15 tenton të shtjelloj tutje përshtypjet dhe përqendrimin e respondentëve, duke kërkuar elaborat mbi zgjedhje alternativa për kategoritë që shfrytëzohen në institucionin ku ata janë të angazhuar. Me pyetjen “*Çfarë praktika dhe metoda shfrytëzohen?*” kemi paraqitur disa alternativa të mbyllura dhe kemi kërkuar nga respondentët që të japin përgjigje për secilën kategori sipas vlerësimeve dhe njohurive të tyre. Rezultate e paraqitura në tabelën e radhës:

Tabela 9 pjesëmarrja në përgjigje dhe devijimi standard

		Udhëzim një për një	Udhëzime të grupeve të vogla	Udhëzime të grupeve të mëdha	Udhëzime të bazuara në kompjuter	Udhëzime të drejtpërdrejta	Vetë- menaxhim menaxhimi i sjelljes	Pa udhëzime speciale	Punë përmes kompjuterit me udhëzime	Punë përmes mjeteve tjera teknologjike
N	Valid	865	852	865	865	865	865	865	865	865
	Missing	0	13	0	0	0	0	0	0	0
Mean		.8590	.7136	.9283	.8335	.4717	.2902	.9861	.8717	.8728
Std. Deviation		.34826	.45234	.25810	.37272	.49949	.45410	.11703	.33464	.33335
Percentiles	5	.0000	.0000	.0000	.0000	.0000	.0000	1.0000	.0000	.0000
	25	1.0000	.0000	1.0000	1.0000	.0000	.0000	1.0000	1.0000	1.0000
	50	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	.0000	.0000	1.0000	1.0000	1.0000
	75	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000	1.0000

Siç tregon tabela e sipërme përgjigje në të gjitha alternativat janë plotësuar nga të gjithë respondentët, përveç tek opsioni “*Udhëzime të grupeve të vogla*” ka pas zbrazëti në trembëdhjetë pyetësorë. Devijimi standard që paraqet 95% të vlerave duke ilustruar ndryshimet e përgjigjeve është tregues pozitiv posaçërisht tek alternativat “*Udhëzime të drejtpërdrejta*” dhe “*Vetë-menaxhim menaxhimi i sjelljes*” me qenë se vlerësimet ishin pozitive. Ndërsa për të shikuar tutje në detaje pranimin e përgjigjeve, shikojmë tabelën e radhës në të cilën paraqesim aspektet statistikore me sasi dhe përqindje

Tabela 10 Shfrytëzimi i praktikave dhe metodave

Udhëzim një për një		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	PO	122	14.1	14.1	14.1
	JO	743	85.9	85.9	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Udhëzime të grupeve të vogla					
Valid	PO	244	28.2	28.6	28.6
	JO	608	70.3	71.4	100.0
	Total	852	98.5	100.0	
Missing	System	13	1.5		
Total		865	100.0		
Udhëzime të grupeve të mëdha					
Valid	PO	62	7.2	7.2	7.2
	JO	803	92.8	92.8	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Udhëzime të bazuara në kompjuter					
Valid	PO	144	16.6	16.6	16.6
	JO	721	83.4	83.4	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Udhëzime të drejtpërdrejta					
Valid	PO	457	52.8	52.8	52.8
	JO	408	47.2	47.2	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Vetë-menaxhim menaxhimi i sjelljes					
Valid	PO	614	71.0	71.0	71.0
	JO	251	29.0	29.0	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Pa udhëzime speciale					
Valid	PO	12	1.4	1.4	1.4
	JO	853	98.6	98.6	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Punë përmes kompjuterit me udhëzime					
Valid	PO	111	12.8	12.8	12.8
	JO	754	87.2	87.2	100.0
	Total	865	100.0	100.0	
Punë përmes mjeteve tjera teknologjike					
Valid	PO	110	12.7	12.7	12.7
	JO	755	87.3	87.3	100.0
	Total	865	100.0	100.0	

Në përgjigjet ku është e përfshirë teknologjia informative siç mund të vërehet ka ngecje dhe si rezultat nuk paraqet pritshmëri pozitive. Praktikrat që shfrytëzojnë 16.6% apo 144 nga 865 respondentë lidhen me udhëzime të bazuara në kompjuter, që nënkupton vetëm

16.6% të mundësive shfrytëzojnë udhëzime nga kompjuter por jo domosdoshmërisht me kompjuter. Ndërsa puna përmes kompjuterit me udhëzime shfrytëzohet nga 12.8% apo vetëm 111 nga 865 respondentët dhe punë përmes mjeteve të tjera teknologjike me 12.7% apo vetëm 110 nga 865 respondentët, që në thelb duke i shikuar edhe alternativat tjera dhe praktikrat që shfrytëzohen nga të angazhuarit në institucionet edukativo-arsimore e që përfshijnë teknologji të ndryshme janë të ulëta. Shqetësim tjetër paraqet edhe rezultati tek alternativa e punëve në grupe të mëdha, ku vetëm 7.2% apo 62 nga 865 respondentët janë përgjigjur me ‘PO’, ky fakt është shqetësues sepse siç dihet në institucionet edukativo-arsimore klasët janë përplot me nxënës dhe shumica nga respondentët nuk praktikojnë udhëzime grupore që përfshijnë të gjithë në një hapësirë.

Edhe pse jo të gjithë respondentët mund të jenë të sigurt në përgjigjen e pyetjes “A janë dedikuar kompjuter adekuat nxënësve me nevoja të veçanta?” mund të supozohet që pjesa dërmuese mund ta kenë informatën e saktë, prandaj në aspektin e frekuencës dhe ndasinë me sasi dhe përqindje paraqesim figurën me rezultatet e pranuar nga pyetja e lartcekur:




Figura 7 pajisja me kompjuter e nxënësve me nevoja të veçanta

Siç mund të shihet te figura më lartë nga 865 respondentë janë përgjigjur 685 apo rreth 80% e tyre dhe vetëm 93 respondentë apo rreth 13% nga 685 respondentë që i janë

përgjigjur kësaj pyetje kanë thënë po janë të pajisur nxënësit me nevoja të veçanta me kompjuter. Nën supozimin që po të gjithë 685 respondentët janë përgjigjur me saktësi të plotë rezulton që vetëm rreth 13% të kësaj kategorie mund të konsiderohet e plotësuar në këtë aspekt dhe rreth 87% e nxënësve me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë teknologji për të ndihmuar veten e tyre për progres më të lehtë dhe avancim në bashkërenditje me të tjerët.

Që të mblidhen tutje informata mbi perceptimet e respondentëve rreth aftësisë institucionale dhe ngritjes së kureshtjes rreth ndikimit që ata mund ta kenë drejtpërdrejtë në këtë problematikë, kemi parashtruar pyetjen e radhës “*Sa i suksesshëm është programi për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionin ku jeni i/e angazhuar?*” duke krijuar përgjigje me pesë alternativa për zgjedhje duke lartësuar peshën me përqindje sipas vlerësimit të tyre. E pa pritshme, megjithatë, të gjithë 895 respondentë kanë dhënë përgjigje dhe rezultati del të jetë:

Tabela 11 Procesimi i vlerësimeve mbi suksesin e programit

Variable Processing Summary

	Variables				
	Dependent	Dependent	Dependent	Dependent	Independent
	76-100%	51-75%	25-50%	1-25%	0
Number of Positive Values	4	3	512	248	98
Number of Zeros	0	0	0	0	0
Number of Missing					
User-Missing	861	868	346	98	0
System-Missing					98

Të gjithë respondentët dhanë informacionin e tyre dhe siç tregojnë rezultatet pjesa dërmuese ishte në një formë neutrale në përgjigjen e selektuar me rreth 60% duke vlerësuar nga 25-50% dhe rreth 28% nga 1-25% duke dhënë një vlerësim të pritshëm. Në anën tjetër 7 respondentë vlerësojnë shumë mirë dhe mbi 11% e respondentëve vlerësojnë me zero suksesin e procesit të edukimit për fëmijët me nevoja të veçanta në institucionet ku ata janë të angazhuar. Bazuar në vlerësimet e pranuar ku rreth 88% e respondentëve janë neutral dhe anojnë mbi nivelin mesatarë aritmetik, krijojnë përshtypjen që institucionet edukativo-arsimore janë në drejtimin e duhur drejt trajtimit të zellshëm të procesit drejt edukimit dhe përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta.

Pyetja e radhës, kërkon të saktësohen aktivitetet në dy kategori, atë shkollore të përgjithshme dhe të nevojshme speciale. Pyetja “*Cila nga të kategoritë e listuar përshkruan*

më së miri qasjen e institucionit në procesin e edukimit special?” kërkon nga respondentët sqarim mendimi individual dhe të bazuar nga përvoja, jo domosdoshmërisht të lidhur me institucionin ku ai/ajo është e angazhuar:

Tabela 12 Shpërndarja e përgjigjeve sipas torisë Bayesian VLTh

Bayesian Estimates of Group Means^a

Dependent Variables	Posterior			95% Credible Interval	
	Mode	Mean	Variance	Lower Bound	Upper Bound
Materialet e mësimit të përgjithshëm janë shfrytëzuar	.4717	.4717	.000	.4477	.4957
Disa ndryshime të vogla janë aplikuar	.0821	.0821	.000	.0581	.1061
Ndryshime substanciale janë aplikuar	.8659	.8659	.000	.8419	.8899
Janë shfrytëzuar materiale specifike të dizajnuara	.9156	.9156	.000	.8916	.9396

a. Posterior distribution was estimated based on the Bayesian Central Limit Theorem.

Kjo tabelë tregon qartë se ka larshmëri mjaft të diferencuar mes formës dhe hapësirave që shfrytëzohen kur vije në shprehje secila nga katër kategoritë e paraqitura dhe dedikimi mbi shfrytëzimin e hapësirave të rregullta apo ato të dedikuara për edukim special. Kategoria e parë është kontradiktore nëse shikohen vlerat sepse rezultojnë që ka një ndarje po thuajse të përgjysmuar kur thuhet që materialet e mësimit të përgjithshëm janë shfrytëzuar qoftë në hapësira të rregullta mësimore apo në ato të dedikuara special. Kjo na bën të kuptojmë që pavarësisht në çfarë hapësirash punohet materialet e mësimit të përgjithshëm shfrytëzohen. Nëse një gjë e tillë është proces i rregullt dhe i pranueshëm për aftësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, konsiderohet që numrat e vendosur në tabelë pas analizës me SPSS apo duke paraqitur vlerat e sakta 457 nga 865 respondentët apo rreth 53% e tyre deklarojnë që shfrytëzohen hapësirat e mësimit të përgjithshëm dhe 408 apo rreth 47% nga 865 respondentë deklarojnë të kundërtën duke e bazuar këtë në hapësira të dedikuara për mësim special. Në anë tjetër thuhet që janë aplikuar ndryshime të vogla dhe kjo kategori zë peshë me vetëm 71 respondentë apo vetëm rreth 8% nga 865 respondentë të cilët peshojnë me .0821 pikë që e deklarojnë ndryshimin e vogël dhe kategoria e ndryshimeve substanciale reflekton me plotë 749 respondentë apo mbi 85% nga 865 apo thënë .8659 *mean* sa ishin gjithsejtë. Ndërsa kategoria e fundit e kësaj pyetje e cila lidhet konkretisht me materialet e shfrytëzuara është tregues thelbësorë që reflekton pozitivitetin pasi që .9156 *mean*, reflektojnë plotësimin ndryshimit e materialeve në hapësirat për mësim special me plotë 792 respondentë apo mbi 90% nga 865 respondentë.

4.2.2. Përfshirja e teknologjisë në edukim special

Në pjesën e fundit të pyetësorit kemi ndërtuar disa pyetje të cilat pas grumbullimit të perceptimeve, njohurive dhe të arriturave nga respondentët, mund të i shfrytëzojmë për nxjerrjen rezultateve me të cilat mundësohet më qëndrueshëm të paraqiten qëndrimet rreth tezave të ngritura dhe potencialisht identifikimit të çështjeve të rëndësishme rreth nxjerrjes së rekomandimeve që konsiderohen të nevojshme për të plotësuar tutje gjendjen aktuale në institucionet edukativo-arsimore të cilat sfidohen në baza ditore me problemet më fundamentale e padyshim edhe sfida të tjera me ndjekjen e teknologjive të reja dhe përballjes me nxënësit me nevoja të veçanta të cilëve duhet të iu ofrohet edukim speciale në kushte të veçanta dhe në raste në kushte të përgjithshme.

Pyetja e radhës e cila kërkon mendimin e drejtpërdrejtë nga respondentët se si mendohet që forcohet apo ngritet tutje ndihma për nxënësit me nevoja të veçanta duke iu përgjigjur katër alternativave të pyetjes “*Si mendoni që mund të forcohet ndihma për kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta?*” jep shenja të lidhura me hipotezat e ngritura. Rezultatet e nxjerra nga kjo pyetje paraqiten në tabelë e radhës:

Tabela 13 Ngritja e ndihmës me TI për fëmijët me nevoja të veçanta

Case Processing Summary

	A20_1	A20_2	A20_3	A20_4
Series or Sequence Length	865	865	865	865
Number of Missing Values in the Plot				
User-Missing	0	0	0	0
System-Missing	0	0	0	0

The cases are unweighted.

Siç tregon rezultati i paraqitur nga rezultatet e pyetjes së 20 të pyetësorit, në katër alternativat e dhëna janë paraqitur rezultatet e plota nga të gjithë 865 respondentët. Për të mundësuar këtë në programin statistikorë SPSS versionin 2.6 kemi vendosur për secilën alternative vlerën 0.00 që ishte ekuivalente me përgjigje pozitive - PO - dhe pjesën tjetër të mbetur e kemi vendosur numrin 1.00 që nënkupton mospajtim respektivisht me - JO – që si rrjedhojë tregon tabela 13 e cila vlerat zero ka të paraqitura për mungesat e përgjigjeve. Për të vlerësuar nëse H_0 - *Mësimi për mësimdhënës dhe shfrytëzimi i TIK-ut për ndërtimin e procesit që do ta kombinonte mësimin tradicional dhe atë inovative me përfshirjen e TIK-ut në shkollat kosovare, është proces i pakthyeshëm dhe sfidohet nga kërkesat speciale* është apo jo signifikante kemi paraqitur tabelën e radhës e cila paraqet lidhshmërinë e përgjigjes alternative të parë nga pyetja 21

në pyetësorë me të cilën analizohen ngjashmëritë me katër alternativat e pyetjes 20 dhe trajtohet tutje duke paraqitur edhe elaborat grafik mes alternativave sipas përgjigjeve të respondentëve të përzgjedhura duke shfrytëzuar lidhshmërinë mes përgjigjeve të zgjedhura.

Tabela 14 Lidhshmëria mes alternativave sipas versionit P-P Plot

		Correlations				
Control Variables			Pajis institucionin me TI	Pajis institucioni n & nxënësit me TI	Zgjerim i kapacitetit për mësimdhëni e të specializuar	Krijim i hapësirave të veçanta për trajtim special
Të përfshihen në trajnime speciale të gjithë mësimdhënësit	Duke pajisur institucionin me Teknologji Informative (TI)	Correlation	1.000	.000	.955	.799
		Significance (2-tailed)	.	1.000	.000	.000
		df	0	862	862	862
	Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI	Correlation	.000	1.000	.000	.000
		Significance (2-tailed)	1.000	.	1.000	1.000
		df	862	0	862	862
	Duke zgjeruar kapacitetin e mësimdhënësve të specializuar	Correlation	.955	.000	1.000	.763
		Significance (2-tailed)	.000	1.000	.	.000
		df	862	862	0	862
	Duke krijuar hapësira të veçanta për trajtim special	Correlation	.799	.000	.763	1.000
		Significance (2-tailed)	.000	1.000	.000	.
		df	862	862	862	0

Paraqitje e rezultateve krahasuese lidhet përveç me H_0 edhe me dy hipotezat tjera të ngritura dhe vlerëson që po të tri hipotezat janë të pranueshme dhe rrjedhimisht kërkojnë mbështetje. Siç tregojnë rezultatet varianti më i mirëpritur është alternativa e dytë e cila numerikisht është plotësuar si zgjedhja më e kapshme nga 523 respondentë apo rreth 60% e tyre që vlerësojnë se nëse pajisen institucionet por edhe nxënësit me nevoja të veçanta me pajisje të teknologjisë informative H_0 dhe H_1 mund të gjenin mbështetje të plotë, ndërsa për H_2 kërkohet ende kohë për të nxjerrë konkluzione të qëndrueshme rreth vlerësimit të pranueshmërisë.

Njëjtë edhe me aspektin e elaboratit grafikorë po ashtu të nxjerra nga programi statistikorë SPSS vërehet që alternativa 2 nga pyetja 20 e pyetësorit në raport me tri alternativat tjera dallon sepse vlerat e pritshmërisë janë mbi vlerën 80% apo 0.8 dhe po ashtu ngritë edhe aspektin e vrojtimit të problemit duke vlerësuar krahasueshmërinë me alternativën e parë të pyetjes 21 e cila supozon që përfshirja e akademisë në trajnime për trajtimin e mësimdhënies speciale është e rëndësishme dhe prandaj vlera në P-P Plot tejkalon vlerën e pritshmërisë dhe vrojtimit në 0.2 respektivisht rreth 0.25.




Figura 8 Lidhshmëria e përzgjedhjeve sipas metodës P-P Plot

Tre alternativat e paraqitura në pyetjen 20 kanë përafërsisht të njëjtën peshë. Duke iu referuar figurës, vërejmë që alternativat 1, 3 dhe 4 kanë shtrirje lehtësisht të dallueshme edhe pse po të tria alternativet shtrihen me pritshmëri mbi vlerës 0.6 apo 60% dhe atë të vrojtimit rreth 0.1 apo nën 10%. Ky rezultat tregon që h_0 , h_1 dhe h_2 qëndrojnë dhe për të pas sukses nevojiten ndryshime drejtë plotësimeve të sugjeruara nga alternativat e paraqitura në pyetjen 20.

Për të vlerësuar tutje qëndrueshmërinë apo brishtësinë e hipotezave të ndritura me pyetjen 21 po ashtu kemi vendosur katër alternativa të mbyllura dhe kemi përdorur

mënyrën e njëjte me plotësimin e rezultateve në programin statistikorë SPSS, mirëpo, për këtë pyetje kemi aplikuar analizën e qëndrueshmërisë dhe kemi nxjerrë rezultatet në vijim.

Tabela 15 rezultatet e qëndrueshmërisë

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.778	.791	4

Bazuar në metodën e Cronbach's kemi qëndrueshmëri të rezultateve me rreth 78% dhe bazuar në po të njëjtën metodë po të plotësuar me standardin Apha qëndrueshmëria rezulton të jetë mbi 79% për të katër alternativat. Prandaj rezultatet e paraqitura në vijim bazuar në pasqyrën nga tabela #15, mund të konkludojmë që janë numra të qëndrueshëm dhe reflektojnë në hipotezat e ngritura.

Tabela 16 Lidhshmëria mes alternativave - pyetja 21

Inter-Item Correlation Matrix

	Të ndërtohen struktura paralele për trajtim special	Të zhvillohen platforma që mbështetin sistemin për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta	Të adaptohen hapësirat e përgjithshme klasore për integrimin nxënësve me aftësi të kufizuara më lehtë	Të përfshihen në trajnime speciale të gjithë mësime mësuesit
Të ndërtohen struktura paralele për trajtim special	1.000	.728	.393	.353
Të zhvillohen platforma që mbështetin sistemin për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta	.728	1.000	.286	.257
Të adaptohen hapësirat e përgjithshme klasore për integrimin nxënësve me aftësi të kufizuara më lehtë	.393	.286	1.000	.898
Të përfshihen në trajnime speciale të gjithë mësime mësuesit	.353	.257	.898	1.000

Duke filluar me alternativën e fundit është paraqitur krahasueshmëria dhe lidhshmëria me të gjitha alternativave një-për-një, vërejmë që dallimin më të theksuar kemi mes alternativës së parë dhe të katërt me .257 pike apo rreth 25%, ndërsa alternativa e parë me të dytën kanë lidhshmëri dhe ngjashmëri me rreth 90% apo .898, dhe alternativa e tretë dhe ajo a fundit kanë ngjashmëri me rreth 73% apo .728. Dallimi mes përfshirjes në trajnime speciale dhe zhvillimit të platformave që mbështesin sistemin për integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara edhe pse në pjesën e parë të pyetësorit kemi marrë rezultate kontradiktore, duket që respondentët duke u thelua me tezën që është ngritë me të po reflektojnë ndryshime duke thelluar besueshmërinë për nevojën e mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta, dhe rrjedhimisht duke konfirmuar qëndrueshmërinë h2 *perceptimin i arritshmërisë së ndërtimit të një sistemi të ri, adekuat, të lehtë për shfrytëzim, krijon vetëbesim dhe pavarësi të plotë akademike.*

Që ky pozicion të fuqizohet tutje, kemi paraqitur edhe rezultatet mbështesë të nxjerra nga përgjigjet e pyetjes 21, të cilat rezultatet tregojnë besueshmërinë statistikore dhe qëndrueshmëri të rezultateve:

Tabela 17 Përmbledhja statistikore rezultatet e pyetjes 21

Summary Item Statistics

	Mean	Minimum	Maximum	Range	Maximum / Minimum	Variance	N of Items
Item Means	.736	.524	.943	.420	1.801	.047	4

Tabela 18 Përshkallëzimi i rezultateve dhe devijimi standard

Scale Statistics

Mean	Variance	Std. Deviation	N of Items
2.9422	1.534	1.23842	4

Siç tregojnë rezultatet, tabela 17 paraqet përpushmëni me rreth 74% ndaj alternativave dhe rezultateve të diferencës, me minimumin diferencial .524 dhe shtrirjen .420 nën dallimet .47 dhe me tabelën e përshkallëzimit shikojmë devijim me 1.23... në katër alternativat me anë të së cilit rezultat konfirmojmë qëndrueshmërinë e tre hipotezave të ngritura.

Me pyetjen e radhës “*Si mendoni ju që do të ndihmonit një proces të tillë?*” po ashtu kemi limituar përgjigjet me vetëm katër alternativa të mbyllura dhe kemi aplikuar nxjerrjen e rezultateve përmes statistikave me SPSS. Kjo pyetje ka pas tendenca të ndryshohet gjatë

diskutimeve me respondentët sepse aty për aty rekomandoni alternativa tjera sipas mendimeve dhe vlerësimeve individuale, por për shkaqe të rezultateve dhe hipotezave të ngritura një gjë e tillë ishte e pamundur. Edhe kjo pyetje dhe katër alternativat e paraqitura lidhen drejtpërdrejtë me tre hipotezat e ngritura dhe japin vlerësimet e saja për secilën në veçanti.

Tabela 19 Përshkrimi statistikorë mes alternativave nga pyetja #22

Descriptive Statistics

		Statistic	Std. Error	Bias	Bootstrap ^a		
					Std. Error	95% Confidence Interval	
					Lower	Upper	
Me përkushtim të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta	N	865		0	0	865	865
	Minimum	.00					
	Maximum	1.00					
	Mean	.5237		.0010	.0165	.4936	.5572
	Std. Deviation	.49973		-.00032	.00089	.49700	.50029
	Kurtosis	-1.996	.166	.005	.014	-2.005	-1.951
Me dedikim të njëjtë për të gjithë nxënësit pa dallime	N	865		0	0	865	865
	Minimum	.00					
	Maximum	1.00					
	Mean	.8439		.0002	.0123	.8185	.8682
	Std. Deviation	.36313		-.00054	.01173	.33846	.38566
	Kurtosis	1.609	.166	.047	.505	.743	2.762
Duke i ndarë nxënësit në grupe sipas aftësive individuale	N	865		0	0	865	865
	Minimum	.00					
	Maximum	1.00					
	Mean	.9029		.0002	.0101	.8821	.9214
	Std. Deviation	.29628		-.00073	.01373	.26929	.32270
	Kurtosis	5.444	.166	.132	1.091	3.642	7.858
Duke u specializuar për trajtim të nxënësve me nevoja të veçanta	N	865		0	0	865	865
	Minimum	.00					
	Maximum	1.00					

	Mean	.8451		.0002	.0123	.8208	.8694
	Std. Deviation	.36203		-.00057	.01180	.33720	.38373
	Kurtosis	1.655	.166	.049	.512	.811	2.828
Valid N (listwise)	N	865		0	0	865	865

a. Unless otherwise noted, bootstrap results are based on 1000 bootstrap samples

Siç është vepruar edhe me tre përgjigjet paraprake, në programin statistikorë kemi plotësuar me vlerën 1.00 e cila është e barabartë me NULL dhe vlera 0.00 me përgjigje pozitive. Kjo me qëllim që nxjerrja e rezultateve mes të gjithë 865 respondentëve të jetë e qëndrueshme dhe e plotë me mundësi matjeje mbi peshën e secilës alternative.

Tabela 20 Paraqitja numerike e rezultateve për secilën alternativë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Me përkushtim të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta	PO	488	56.4	56.4	54.4
	JO	453	52.4	52.4	100.0
Me dedikim të njëjtë për të gjithë nxënësit pa dallime	PO	159	18.4	18.4	18.4
	JO	730	84.4	84.4	100.0
Duke i ndarë nxënësit në grupe sipas aftësive individuale	PO	84	9.7	9.7	9.7
	JO	781	90.3	90.3	100.0
Duke u specializuar për trajtim të nxënësve me nevoja të veçanta	PO	134	15.5	15.5	15.5
	JO	731	84.5	84.5	100.0
	Total	865	100.0	100.0	

Tabela 19 tregon përshkrimin e peshës për secilën alternativë dhe për të kuptuar tutje dhe më me lehtësi për lexuesin kemi paraqitë edhe frekuencën e përgjigjeve me tabelën 20 po ashtu për secilën alternativë nga pyetja #22. Nëse vlerësojmë devijimin standard duke u bazuar në frekuencën e përgjigjeve të alternativës së parë dhe të tretë ku kemi marrë përgjigje pozitive me 412 PO, respektivisht me 84 PO, devijimi standard nuk është pikë referuese për shqetësim posaçërisht nëse i referohemi hipotezës h1, sepse siç shihet në bias alternativa e parë ka $-.00032$ dhe alternativa e tretë ka $-.00073$ peshën e poentuar. Ndërsa vlerat ndryshojnë drastikisht në po të njëjtën peshore, pra devijimin standard por në kolonën statistikore që tregon gabimet standarde peshohet me $.00089$ ndërsa alternativa e tretë me

.013373, me çrrastë besueshmëria mbi alternativën e parë kalon 50% ndërsa alternativa e tretë paraqet besueshmëri rreth 32%.

Për të forcuar qëndrimin mbi mbështetjen e hipotezave të ngritura, kemi kombinuar alternativën e dytë nga pyetja e 20 e cila alternativë kishte peshën absolute dhe mbështet tre hipotezat e ngritura me pozicionin e plotësimit të institucioneve dhe nxënësve me nevoja të veçanta me pajisje të teknologjisë informative duke bërë mbledhje krahasim dhe peshim të kombinimit të asaj teorie me çështjet dhe perceptimet e mësimeve duke u bazuar në forcat e tyre individuale dhe vullnetit që ata posedojnë dhe dëshirojnë ta fusin në mbështetje e problematikave të ngritura këtu. Tabela e radhës e cila shfrytëzon analizën ANOVA për kombinimin e përgjigjeve dhe nxjerrjen e rezultateve krahasuese tregon fuqizimin e mbështetjet dhe pranimin e po të tre hipotezave të ngritura.

Tabela 21 Lidhshmëria e rezultateve të peshuara nga pyetja 20 alternativa 2 me alternativat e pyetjes 22

ANOVA Table

		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI * Me përkushtim të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta	Between Groups (Combined)	122.980	1	122.980	1266.470	.000
	Within Groups	83.801	863	.097		
	Total	206.782	864			
Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI * Me dedikim të njëjtë për të gjithë nxënësit pa dallime	Between Groups (Combined)	25.006	1	25.006	118.720	.000
	Within Groups	181.775	863	.211		
	Total	206.782	864			
Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI * Duke i ndarë nxënësit në grupe sipas aftësive individuale	Between Groups (Combined)	14.543	1	14.543	65.288	.000
	Within Groups	192.238	863	.223		
	Total	206.782	864			

Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI * Duke specializuar për trajtim të nxënësve me nevoja të veçanta	Between (Combined) u Groups	24.787	1	24.787	117.537	.000
	Within Groups	181.995	863	.211		
	Total	206.782	864			

Nga këndvështrimi krahasues tabela #21 tregon qarte përputhshmërinë mes përgjigjeve të alternativës së parë nga pyetja 20 dhe alternativës së parë nga pyetja 22 e pyetësorit, me anë të së cilave konfirmohet që pajisja me teknologji për institucionin dhe nxënësit me nevoja të veçanta dhe mundësia që ka secili nga respondentët të ofroj përkushtim të veçantë konfirmon të tre hipotezat:

- h0 e cila ngit çështjen e kombinimit të të mësuarit tradicional dhe atë inovative me ndihmën e TIK,
- h1 e cila ngitë çështjen e përqafimit të ndryshimit me gatishmërinë institucionale, dhe
- h2 e cila vë në pikëpyetje perceptimin e arritshmërisë së një sistemi adekuat dhe krijon vetëbesim dhe pavarësi të plotë akademike

Derisa në anën tjetër, kombinimi e përgjigjeve nga alternativa e parë e pyetjes 20 dhe alternativave tjera nga pyetja 22, po ashtu konfirmojnë që pavarësisht nëse pajisjen institucionet dhe nxënësit me nevoja të veçanta me teknologji informative, nëse ato nuk mbështesin qëndrueshmëri dhe bashkim e integrim me pjesën tjetër të nxënësve nuk mund të ketë qëndrueshmëri. Kjo tregohet qartazi nga tabela 20, ku kombinimi i alternativave të para nga pyetjet 20 dhe 22 fuqizojnë mbështetjen e tre hipotezave me mbi 55% në raport me kombinimet mes alternativave të tjera.

Një pyetje me përgjigje të drejtpërdrejta dhe të mbyllura me alternativa të plota është paraqitur në pyetësorë për të nxjerrë në pah kuptueshmërinë e respondentëve rreth çështjes së ngritur dhe kuptimit mbi dallimin mes kategorisë së nxënësve me nevoja të veçanta dhe perceptimit të mësimdhënësve mbi shfrytëzimin e teknologjisë në veçanti për edukim special. Pyetja e radhës e 23-ta me radhë “A mendoni që teknologjia informative do të ndikonte pozitivisht në arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta?” kishte alternativat PO, JO dhe nuk e di.

Rezultati i paraqitur në tabelën e radhës është bazuar procedimin e përmbledhjes shtrirës duke evidentuar dallimet nga mungesat e përzgjedhjes me vendosjen e numrit 0.00 për përgjigje mbështetëse me një PO që konfirmon përzgjedhjen e alternativës dhe me numrin 1.00 për plotësimin e numrit të plotë krahasues të 865 respondentëve të cilën zgjedhin alternativat tjera, dhe me këtë konfirmon hipotezat e ngritura me mbi 93%, refuzon të tre hipotezat me rreth 5% dhe nuk jep sqarime nga më pak se 1% e respondentëve, me të cilat përgjigje konfirmohet mbështetja e tre hipotezave të ngritura. Mbetet shqetësues fakti edhe pse me përqindje relativisht të ulët me më pak se 1%, qasja e respondentëve të cilën nuk e konfirmojë apo refuzojnë me pozicionin e tyre perceptimin kuptimplotë mbi shfrytëzimin e teknologjisë nga institucionet dhe nxënësit me nevoja të veçanta.

Tabela 22 Procesimi i përgjigjeve nga pyetja 23 me gjatësi serike

Case Processing Summary

	PO	JO	Nuk e di
Series or Sequence Length	865	865	865
Number of Missing Values in the Plot			
Negative or Zero Before Log Transform	811 ^a	46 ^a	7 ^a
User-Missing	0	0	0
System-Missing	0	0	0

Kuptimi dhe shtytja drejtë sfidës individuale kalon tek pyetja e parafundit, me çrrastë respondentëve iu kërkohet sqarim mbi ndjenjat e tyre në ballafaqim me trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta çoftë kjo në procesim të hapësira apo mësimin special apo në procese konvencionale të të mësuarit në shkollat kosovare. Natyrshëm, me grumbullimin e përgjigjeve nga kjo pyetje të cilës i kemi vënë katër alternativa tre prej të cilave lidhen me perceptimin e mësimdhënësve në ballafaqim me nxënësit me nevoja të veçanta dhe një alternativë që liron ata nga ky përvetësim me qenë se nuk janë ballafaquar asnjëherë me nxënës me nevoja të veçanta.

Tabela 23 Perceptimi individual në ballafaqim me trajtimin e mësimit me nxënës me nevoja të veçanta

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Ndihem i privilegjuar që kam mundësi të ndihmoj	PO	165	19.1	19.1	19.1
Ndihem i mangët dhe emocionalisht i thyer	PO	364	42.1	42.1	42.1
Ndihem i brishtë sepse nuk po arrij të jap aq sa ju nevojitet	PO	64	7.4	7.4	7.4
Nuk kam punuar asnjëherë me kategori të tillë	PO	272	31.4	31.4	31.4
	Total	865	100.0	100.0	100.0

Rezultatet e dala dhe të paraqitura në tabelën 23 tek alternativa e parë tregojnë perceptim, dhembshmëri dhe vullnet nga vetëm 19.1% e respondentëve, me çrrestë lejon të vlerësohet që hipotezat e ngritura qëndrojnë dhe njëkohësisht kërkojnë ndryshimin e merituar duke krijuar kushte më të përshtatshme për të ballafaquar integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në proces të rregullt mësime me mjete lehtësuese. Tek alternativa e dytë e cila është plotësuar nga pjesa më e madhe e respondentëve me mbi 40% konkludon që zhvillimet e trajnimeve për mësime për punë me nxënës me nevoja të veçanta janë të domosdoshme. Në këtë pjesë natyrisht duhet të përfshihet e tërë gama institucionale. Alternativa tre e cila është selektuar nga vetëm 64 respondentë që përbëjnë 7.4% nga 865 përforcon tutje qëndrueshmërinë e h2 me çrrestë ndryshimet në procesin edukativo-arsimorë ka nevojë të reformohet dhe së bashku me procesin duhet të reformuar edhe mësime për t'iu adaptuar ndryshimeve. Përfundimisht alternativa e fundit në pyetjen e parafundit tregon që - përkundër ndryshimeve nga përgjigjet e mëparshme nga pyetjet e paraprake - 31.4% konsiderojnë që nuk ishin të angazhuar asnjëherë apo ballafaquar asnjëherë me nxënës me nevoja të veçanta apo me kërkesa për trajtim special.

Sipas MASHTI-it gjatë vitit shkollor 2020/2021⁶, nxënës me nevoja të veçanta ishin 3939, edhe pse ky numër duket të jetë jo shumë i lartë, krahasuar me numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkolla të ulëta të mesme dhe të larta të mesme në nivel vendi janë rreth 300,000⁷ nxënës e që vërteton se nxënës me nevoja të veçanta janë mbi 1% e vijuesve të mësimit dhe krahasueshëmish mësime për punë me nxënës me nevoja të veçanta ka shumë më pak. Përderisa në raportin e njëjtë statistikorë gjatë vitit shkollor

⁶ Statistikat e Arsimit në Kosovë, Qershor 2021, <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

⁷ Po Aty

2017/2018⁸ ishin vlerësuar të jenë 4451 nxënës me nevoja të veçanta. Dallim goxha i madh mes dy gjeneratave, për të cilat nuk ka shënime matëse, vetë mund të konkludohet që ka pas efekt pandemia e COVID19 në evidentimin e plotë apo mos dërgimin e fëmijëve në proces edukativo-arsimorë.

Në pyetjen e fundit kemi kërkuar nga respondentët që të japin mendimin e tyre rreth ndihmës që mund ta ofrojnë duke reflektuar në kushtet e paraqitura nga katër alternativat e paraqitura. Edhe kjo pyetje lidhet me perceptimin dhe ngritjen e nivelit të procesit mësimorë në përgjithësi, e në veçanti për kategorinë e procesit mësimorë special me nxënës me nevoja të veçanta. Pyetja # 25 “A mendoni që kontributi i juaj në punën me nxënës me nevoja të veçanta do të ishte më i mirë, nëse?” lidh burimin individual me atë institucional, duke iu krijuar hapësirë respondentëve të reflektojnë në mangësitë institucionale që janë pengesë për të u ngritur profesionalisht dhe moralisht drejtë trajtimit të procesin edukativo-arsimorë dhe ndryshimit të edukimin në përgjithësi duke përfshi edhe përkushtimin dhe vullnetin individual së bashku me forcën institucionale e cila ka potencialin që nxënësit me nevoja të veçanta të i trajtoj më me dinjitet.

Tabela 24 Statistikat përshkruese të niveleve të faktorëve brenda subjektit

Descriptive Statistics of Within-Subject Factor Levels

Dependent Variables	Mean	Std. Deviation	N	Min	Max
Institucioni ku jeni i/e angazhuar do të krijonte hapësira të veçanta për trajtimin e punës dhe dedikimit ndaj nxënësve me nevoja të veçanta	.8705	.33592	865	.00	1.00
Institucioni ku jeni i/e angazhuar ofron tretman special në hapësira të përgjithshme klasore ose të tjera	.5780	.49416	865	.00	1.00
Institucioni ku jeni i/e angazhuar do të shfrytëzonte TI për arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta	.7584	.42831	865	.00	1.00
Institucioni ku jeni i/e angazhuar ofron kurse speciale për mësimdhënës për trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta	.7931	.40534	865	.00	1.00

⁸ Statistikat e Arsimit në Kosovë, Qershor 2018, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/07/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2017-18.pdf>

Siç vërehet në paraqitjen e rezultateve në tabelën 24, janë paraqitur për secilën alternativë rezultate përshkruese për 865 respondentë së bashku me formën *Mean* dhe devijimin standard për të reflektuar qëndrueshmërinë në raport me tre hipotezat e ngritura. Alternativa e parë nuk është mbështet mjaftueshëm, kjo është selektuar nga rreth 13% e respondentëve dhe rrjedhimisht bie ndesh me hipotezat e ngritura që reflekton jo qëndrueshmëri. Alternativa e dytë me të cilën pretendohet që ngritja e cilësisë dhe trajtimit të procesit edukativo-arsimorë në veçanti me nxënësit me nevoja të veçanta është mbështet nga 43% e respondentëve me çrrastë konfirmon qëndrueshmërinë e të hipotezave h1 dhe h2 dhe mbështetje të hipotezës h0, ndërsa plotësimin e saj e bën alternativa e tretë e cila është plotësuar nga rreth 25% e respondentëve të cilët konfirmojnë dhe mbështesin hipotezën e parë h0 e cila me përfshirjen e teknologjisë informative aplikon domosdoshëm mbështetje edhe të dy hipotezave tjera. Me këtë pozicion analitik rezultatet e paraqitura nga përgjigjet në alternativat e paraqitura, konfirmojnë qëndrueshmëri të hipotezave të ngritura me rreth 68% dhe si rrjedhojë konsiderohen si të pranueshme.

KAPITULLI V

5.1. PËRFUNDIME

Nga ky këndvështrim, një gjetje përfundimtare e dukshme e këtij studimi ishte rëndësia e shqyrtimit jo vetëm të perceptimeve të mësimdhënësve dhe ndikimit të teknologjisë informative në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimorë posaçërisht për nxënës me nevoja të veçanta, por edhe nevoja për modifikime të ndryshme udhëzuese për sa i përket realizueshmërisë dhe dëshirës për plotësime, për kuptimin e asaj se si mësimdhënësit mund t'i përshkruajnë ndryshimeve të ndryshme dhe si mund të mishërohen me ato përshtatje në praktikën e përditshme.

Edhe pse ky nuk ishte një qëllim i paracaktuar i studimit, analiza cilësore e përgjigjeve zbuloi se mësimdhënësit kanë numër të konsiderueshëm keqkuptimesh në lidhje me përshtatjet e ndryshme. Për shembull, një pjesë mësimdhënësve që nuk janë ballafaquar asnjëherë me nxënës me nevoja të veçanta jepnin vlerësime për çështje të caktuara që binin ndesh me mendimet e atyre mësimdhënësve të cilët punojnë në baza të rregullta me ato kategori të nxënësve. Ofroheshin metoda dhe vlerësime diametralisht të ndryshme, dhe krijonin përshtypjen që ose nuk e kuptojnë fare trajtimin special për kategoritë e nxënësve që kanë nevoja të veçanta, ose nuk analizonin sa duhet dhe në pyetësor jepnin përgjigje kontradiktore mes njëra-tjetrës.

Me vlerësime përmblendhëse, alternative dhe me materiale të rregullta, përshtypjet që brenda grupit të klasës me punë në grupe, aktivitete të ndryshme me diferencim negativ dhe një qasje të pa-diferencuar të një klase të tërë si një mjet për të siguruar barazinë doli si nocion i kuptimeve që rezultojnë negativitet nga rëndësia e trajtimit të nxënësve me nevoja të veçanta duke përfshi dallimin mes nxënësve dhe përfshi edhe rolin e TI-së në aspektin e perceptimeve nga mësimdhënësit. Këto zbulime plotësojnë dyshimet për mungesën e njohurive dhe kanë implikime serioze në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit të mësimdhënësve, që nënkupton, mësimdhënësit nuk mund të pyeten ose trajnohen për të zbatuar kurrikula të reja dhe të përdorin metoda të reja udhëzuese ose të ndërmarrin modifikime. Pa marrë parasysh që mësimdhënësit duhet të marrin pronësinë e procesit të mësimin të tyre duke ndërtuar një kuptim të programeve dhe metodave të reja dhe duke përdorur njohuritë e tyre paraprake si dhe keqkuptimet e tyre të mëparshme.

Për shkak të rëndësisë së saj, mënyra se si mësimdhënësit interpretojnë modifikime të ndryshme mësimore kanë nevojë për hulumtime të mëtejshme duke përdorur intervista dhe vëzhgime *on-line* në klasat e arsimit të përgjithshëm, ato speciale dhe ajo më e rëndësishme në klasat ku ka përzjerje me nxënës të rregullt dhe nxënës me nevoja të veçanta. Mbi të gjitha, faktori më kritik për arsimin gjithëpërfshirës mbetet mësimdhënësi - çfarë mendojnë dhe besojnë mësimdhënësit - dhe fusha më e rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës është kombinimi i klasës së rregullt apo fushëveprimi i rregullt për aktivitetet shkollore me involvimin në çdo hapësirë dhe aktivitet nxënësit me nevoja të veçanta.

E veçanta e këtij studimi ishte matja mbi konfirmimin e hipotezave të ngritura. Siç tregojnë rezultatet e paraqitura, nga numri i pyetësorëve të shpërndarë, kemi pranuar përgjigje nga 865 respondentë dhe vlerësimet e përgjigjeve të pranura i kemi zbërthyer me metoda të ndryshme statistikore duke shfrytëzuar programin statistikorë SPSS versionin 2.6, me çrrestë na janë konfirmuar qëndrueshmëria e tre hipotezave të ngritura.

Ky rrugëtim për h_0 vetëm ka filluar dhe padyshim mbetet i pakthyeshem. Kjo është vërtetuar edhe nga hulumtimi të tjera, u forcua nga zhvillimet e teknologjisë informative dhe shfrytëzimi në masë të madhe gjatë periudhës pandemike që fillojë gjatë vitit akademik 2019/2020 duke vazhduar edhe sot, si dhe në kombinimin e disa përgjigjeve që kemi sigurua me bashkëpunëtorët respondentë, rezultatet e komentuara më lartë konfirmojë që h_0 qëndron dhe duhet mbështetur në vazhdimësi. Po ashtu h_1 dhe h_2 gjatë rrugëtimit me hartimin e këtij studimi kishin mbështetje si për nga koha e ndryshime nga rrethanat e krijuara me situatën pandemike dhe lehtësirave që TI i sjell procesit edukativo-arsimorë në veçanti për nxënës me nevoja të veçanta, po ashtu edhe nga perceptimi për arritshmërisë së përmirësimeve dhe lehtësirave për shfrytëzimin e TIK në përgjithësi.

Sfidë mbetet vendimi për të zyrtarizuar nevojën për ndryshimet e nevojshme dhe të merituar. Për të arritur këtë duhet hartuar një strategjie të qëndrueshme dhe planifikimet për zbatime. Duke analizuar këtë dukuri dhe mangësitë që ka procesi edukativo-arsimorë me teknologji posaçërisht në vendet në zhvillim vlerësohet që një strategji e hartuar mirë me plane dhe afate zbatimi në aspektin kohorë dhe logjistik të arritshme fondet do siguroheshin.

Aspekti tjetër i rëndësishëm mbetet vlerësimi i sinqeritetit dhe bazimit mbi njohuritë e respondentëve për përgjigjet e dhëna në pyetësor. Kjo për arsien e marrjes së përgjigjeve kontradiktore dhe mosnjohjes së procesit të të mësuarit special me nxënës me nevoja të veçanta dhe mungesës së informatave të përgjithshme për mësimdhënësit nëse në

institucionin ku ata janë të angazhuar ka nxënës me kategori të veçuar dhe nevoja të veçanta dhe si e sa institucioni ka bërë ndryshime për të akomoduar dhe inkuadruar këtë kategori në procesin e rregullt dhe sistemimin e aplikimin e ndryshimeve.

Perceptimet e mësimitdhënësve për shfrytëzimin e teknologjisë informative me nxënësit me nevoja të veçanta mbështet me mbi 65% e respondentëve dhe si rrjedhojë kërkon vëmendje për plotësimin e kushteve të përgjithshme. Duke pas parasysh që në Kosovë llogaritet që nxënës me nevoja të veçanta janë nën 1% e nxënësve në nivel vendi, konsiderohet që nuk është e vështirë - me ndonjë përjashtim - të plotësohet ky kriter në nivel vendi. Megjithatë duhet pas parasysh që për këtë duhet rritur numri i mësimitdhënësve të përgatitur për punë me nxënës me nevoja të veçanta të rritet dukshëm.

Në dy pyetjet qëllimi i të cilave ishte zëbrthimi i studimit: *Sa janë të gatshëm mësimitdhënësit të zëvendësojnë procesin tradicional edukativo-arsimorë me inovacionet që imponohen nga TIK? dhe Çfarë nevojitet të bëjnë institucionet që të adaptohet platforma e mësimit me TIK në Kosovë?* Konsiderohet që janë marrë përgjigjet e nevojshme dhe të qëndrueshme.

P1: Mësimitdhënësit, janë të gatshëm të bëjnë plotësimet e nevojshme për të plotësuar - jo zëvendësuar - procesin tradicional edukativo-arsimorë dhe për të realizuar këtë nevojitet mbështetje profesionale, administrative dhe logjistike. Mësimitdhënësit, duke u bazuar në aspektin e notës së mbivlerësuar në raport me nevojën për të ushqyer veten me dije, krijojnë pasiguri nëse në këtë kohë dhe në formë të pa testuar mjaftueshëm, nuk e mbështetin zëvendësimin e mësimit tradicional, përkundër që e mirëpresin kohën për mundësimin e realizimit të një procesi për ndryshim të qëndrueshëm.

P2: Institucionet duhet të ngrehin zërin dhe të mishërojnë një proces - i cili është dëshmuar i suksesshëm në vendet e zhvilluara – të adaptueshëm për kategorinë dhe mundësinë që e ka Kosova aktualisht, duke u siguruar që rrugëtimin ta kenë dinamik dhe të ndryshueshëm për t'iu adaptuar kohës dhe rrethanave. Kosova nuk mund të shfrytëzojë platforma të gatshme të cilat vihen në dispozicion në tregun ndërkombëtarë, por duhet të i përshtatet rrethanave, posaçërisht në aspektin e vlerësimit demografik dhe qasjes që mund ta kenë institucionet në internet dhe nxënësit që vijojnë mësimin në ato hapësira.

Arsimi Kosovarë nuk ka treguar rezultate të mira në tre dekadat e fundit, dhe kjo, fatkeqësisht kohën e fundit vetëm sa shkon e thellohet - bazuar edhe në vlerësimet ndërkombëtare të PISA, prandaj thellimi për zhvillimin e TIK në institucione duhet bazuar në strategji të mirëfilltë dhe të zbatueshme në plane konkrete afat-mesme dhe afat-shkurta duke

bërë matje të vazhdueshme të rezultateve dhe adaptuar strategjinë si rrjedhojë e plotësim ndryshimeve në zhvillimet e TIK dhe aftësive të ngritura në vazhdimësi të mësimdhënësve në kuadër të strategjisë zhvillimore dhe profesionale.

5.2. REKOMANDIMET

Duket qartë se një projekt që trajton nxënësit me nevoja të veçanta është po aq i ndjeshëm sa edhe i rëndësishëm. Kosova ka nevojë për ndryshime të mëdha që të arrij nivelin e kënaqshëm për trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta. Problemet që ka arsimiti kosovarë nuk janë të pakta dhe prioritetet nuk janë të fokusuar tek 1% i nxënësve me nevoja të veçanta, fatkeqësisht.

Rekomandohet që të ngritet zëri i mësimdhënësve së merren drejtpërdrejtë me nxënës me nevoja të veçanta duke kërkuar plotësim të numrit të trajnimeve speciale, të plotësohen me pajisje të teknologjive informative dhe të tjera që ndihmojnë progresin e integritit të nxënësve me nevoja të veçanta duke iu mundësuar barazinë në çdo cep të jetës. E rëndësishme dhe sfidë që duhet gjete rrugë për trajtim është mundësia e qasjes fizike në të gjitha hapësirat shkollore, posaçërisht për nxënësit që kanë probleme me lëvizje që shfrytëzojnë karroca. Po marr si shembull SHFMU-Dardania e cila ka frekuentim të madh të nxënësve dhe kategoria e nxënësve që shfrytëzojnë karroca për lëvizje aty nuk mund ta vijnë mësimin si pasojë e mungesës së qarkullimit të lirë.

Nevojitet organizimi i trajnimeve speciale për mësimdhënës dhe përgatitje e së paku tetë mësimdhënësve në çdo shkollë të mesme të ulët dhe pesë mësimdhënësve në shkolla të mesme të larta duke krijuar komoditet për pritshmëri të secilit nxënës në cilëndo shkollë në nivel vendi, dhe së paku shtatë shkolla speciale të pajisura dhe me personel të përgatitur për punë me nxënës me nevoja të veçanta, pavarësisht cila aftësi e nxënësit mund të jetë e kufizuar.

MASHT duhet të ketë në çdo moment informata të nevojshme për trajtimin e kategorisë së nxënësve me nevoja të veçanta, por nuk duhet të limitohen aty. Duhet të pajisin secilën shkollë me kabinete të teknologjisë informative dhe pajisje të tjera relevante për të krijuar mundësinë e përfshirjes së të gjithë nxënësve pa dallime në kufizimet e mundshme duke krijuar atmosfera të pranueshme për të gjithë, në mënyrë që të lehtësohet integrimi i nxënësve me nevoja të veçanta më lehtë në rrethin e tyre shoqërorë.

Që të lehtësohet progresi për integrim të TIK në mënyrë që të ndihmon mësimdhënësit për t'iu bashkuar kërkesën globale për të zëvendësuar procese dhe metodat tradicionale të mësimdhënies dhe për ta përforcuar atë me mjete mësimore të bazuara në teknologji, nevojitet që të bëhen plotësim ndryshime në po thuajse të gjitha sferat e procesit që lidhen me zhvillimet e proceseve mësimore. Vendet e zhvilluara të cilët janë më afër zhvillimeve të ndryshme duke përfshi edhe konsolidimin e nxënësve me nevoja të veçanta në aspektin shoqërorë, duhet të ngritët vetëdijesimi për ngritje individuale. Sot më shumë se kurrë TIK shfrytëzohet nga të rinjë e të reja të të gjitha moshave, fatkeqësisht, kjo nuk po e ndihmon të mësuarit individual edhe pse informacionin po e kanë në duart e tyre gjatë gjithë kohës. Është shumë e rëndësishme që të ndryshoj nocionin i notimit posaçërisht në klasat e ulëta, për të krijuar mundësinë e ngritjes dhe rëndësisë për ngritje individual dhe jo notim. Në vendin tonë nota përbën kriterin kyç në arsim dhe i tërë procesi semestral apo vjetorë lidhet dhe diskutohet rreth notës! Me këtë krijohet bindja që nota ka vlerë më të lartë se mësimi dhe shfrytëzimi i teknologjisë në kombinim me aftësinë dinake gjatë testeve të ndryshme jep rezultate të mira në aspektin e notimit, por jo edhe me përvetësimin e dijës individuale apo grupore rreth lëndës së trajtuar.

5.3. HULUMTIMET E MËTUTJESHME

Kuptimi i zhvillimeve teknologjike të informacionit dhe komunikimit duhet të pajiset me përballimin e sfidës së procesit të përvetësimit të dijës dhe përfshirjen e secilës kategori të nxënësve në një shoqëri të pasuruar me dije dhe dëshirë për zhvillim.

Shkollarëve që trajtojnë sfidat e arsimimit, në theks të veçantë të atyre me nevoja të veçanta, iu rekomandojmë që të marrin rezultatet e paraqitura në këtë studim dhe të zhvillojnë tutje thellimin mbi gjetjen e rrugëve të realizueshme për integrimin e TIK në procesin mësimorë pa cenuar kredibilitetin e mësimdhënësve duke iu plotësuar nevojat individuale dhe përgatitjeve për shfrytëzimin e TIK në nivele profesionale. Siç u paraqit këtu perceptimi i mësimdhënësve për shfrytëzimin e TIK nga nxënësit me nevoja të veçanta mbështetet në masë. Edhe pse ka një hezitim të përgjithshëm që shtrirja e TIK në nivel shkollor për të gjithë nxënësit duke pas parasysh vlerësimin e notës para dijës, kjo përshtypje e qëlluar duhet anashkaluar duke përgatitur mësimdhënësit në radhë të parë për trajtim profesional të lëndëve që trajtojnë me përgatitje meritore në njërën anë dhe ngritjen e aspektit pedagogjik dhe respektimin e nxënësit pavarësisht aftësive mbi ritmin e zhvillimit të dijës.

Krejt në fund, rekomandojmë që ky studim, përkatësisht pjesa e analizës së rezultateve, gjetjeve dhe vlerësimeve përfundimtare të shpërndahen mes shkollarëve profesional dhe akademik për ta ngritur zërin tutje dhe përforcuar perceptimet pozitive të mësimdhënësve mbi aspektin e shfrytëzimit të TIK në institucione edukativo-arsimore, në veçanti dhe me theks të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta.

5.2. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2019). *Statistikat e Arsimit në Kosovë*. Prishtinë: ASK.
- Benya, W. (2011). *A comparison of the effectiveness laboratory activities in a high school*. Michigan Technological University-
<https://pdfs.semanticscholar.org/51a2/60205372661955c29d208650fd9f83efb21d.pdf>.
- Blaxter, L., Hughes, C., & Tight, M. (2001). *How to Research*. Buckingham: Open University Press.
- Coffman, T. (2006). *Using Simulations to Enhance Teaching and Learning: Encouraging the Creative Process*. The VSTE Journal is published by the Virginia Society for Technology in Education.
- company, N. s. (1998). *w3school*. Gjetur në w3school: <https://www.w3schools.com/about/>
- Creswell, J., Hanson, W., Pano, V. C., & Morales, A. (2007). Qualitative Research Designs: Selection and Implementation. *Sage Journal*, 236-264.
- De Jong, T. &. (2012, Mars). The Efficacy of Simulation as a Pedagogy in Facilitating Pre-Service Teachers' Learning About Emotional Self-Regulation and its Relevance to the teaching Profession. *Australian journal of teacher education*, 36.
- Foundations, W. P. (2018, February 15). *Lynda.com*. Gjetur në LinkedIn: <https://www.lynda.com/Web-Development-tutorials/What-code-editor/667390/710458-4.html>
- Ghavifekr, S., Afshari, M., & Salleh, A. (2012). Management strategies for e-learning system as the core component of systemic change: A qualitative analysis. *Life Science Journal*, 3.
- Gibson, D. &. (2006). *Digital Simulations for Improving Education: Learning Through Artificial Teaching Environments*. London: Information Science Reference.
- Kagan, S. (1999). *Leadership Games: Experiential Learning for Organizational Development*. Sage.
- Kincaid, J. &. (2009). *Simulation In Education and Training*. Orlando: University of Central Florida-<https://www.informs-sim.org/wsc09papers/024.pdf>.

- Landriscina, F. (2012). *Simulation and Learning*. New York: Università degli Studi di Trieste.
- Magee, M. (2006). *Simulation in Education*. <https://pdfs.semanticscholar.org/cf57/5e98c02fafc71270cb6bea7eed6979338183.pdf>.
- Mark Grabe, C. G. (2007). *Integrating technology for meaningful learning - Fifth Edition*. Boston: Houghton Mifflin.
- Michael, K. Y. (2010). The Effect of a Computer Simulation Activity versus a Hands-on Activity on Product Creativity in Technology Education. *Journal of Technology Education*, 31.
- Myers, M. D. (1997). Hulumtimi kualitativ në Sistemet e Informacionit. *MIS*, 241-242.
- Pimentel, J. (1999). Design of Net-learning Systems Based on Experiential Learning. *JALN*, issue 1, 64-90.
- Shead, S. (2020, 05 31). *CNBC*. Gjetur në <https://www.cnbc.com:https://www.cnbc.com/2020/05/20/cambridge-online-only-2021.html>
- Stančić, H. &. (2007). *Simulation Models in Education*. Zagreb, Croatia: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.509.5310&rep=rep1&type=pdf>.
- Weiser, M. (1991). The Computer of the XXI-se century. *Scientific Amerikan*, 1-2.
- Winsberg, E. B. (2010). *Science in the Computer Age of Simulation*. Chicago & London: https://www.researchgate.net/publication/257623136_Eric_Winsberg_Science_in_the_Age_of_Computer_Simulation.

ANEX 1

Të nderuar edukatorë dhe punonjës në arsimin kosovarë,

Për qëllime akademike dhe duke dashur të ndriçojmë situatën e cila mbretëron me sfidat ditore në institucionet edukativo-arsimore drejt ofrimit sa më cilësorë për edukim dhe zhvillim të rinjve me nevoja të veçanta, kemi hartuar pyetësin, që natyrisht, vetëm me ju mund të sigurohet informacioni kaq i rëndësishëm. Prandaj, megjithëse e vlerësojmë shumë kohën tuaj, dhe e kuptojmë që jeni shumë të zënë, ju lusim ta plotësoni këtë pyetësor sa më saktë që të jetë e mundur. Informacioni që ju jepni po mblidhet vetëm për qëllime kërkimore dhe do të ruhet në mënyrë sekrete.

Me hartimin e punimit po ashtu për qëllimet e arritjeve akademike dhe përfundimit të studimeve të shkallës së tretë, me tendencën e ngritjes së cilësisë së procesit edukativo-arsimorë për fëmijët me nevoja të veçanta, po ju ofroj një sfidë të vlefshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të paraqitura. Pyetësi nuk merr më shumë se 10-15 minuta kohë dhe ndihmon përveç plotësimit të kriterit akademik edhe në ndikimin e ngritjes së zërit për zgjerimin dhe plotësimin e standardeve të nevojshme për të inkuadruar të rinjë e të reja në të gjitha shtresat e shoqërisë në vendin tonë.

Ju falënderoj shumë për ndihmën tuaj.

1. Cila është gjinia juaj?
 - Mashkull 1
 - Femër 2
 - Shëno vitin e lindjes _____
2. Cili është niveli më i lartë i shkollimit të cilin e keni përfunduar?
 - Shkolla e mesme 1
 - Shkolla e lartë 2
 - Fakultet (4 vjeçarë) 3
 - Fakultet (3 vjeçarë Bachelor) 4
 - Master 5
 - Shkollën Doktrate 6
3. Duke llogaritur vitin aktual (përfshirë edhe punën me orar të shkurtuar) sa vite keni që jeni duke punuar në institucione edukativo-arsimore?

4. Duke llogaritur vitin aktual (përfshirë edhe punën me orar të shkurtuar) sa vite keni që jeni duke punuar me nxënës me nevoja të veçanta apo diçka të ngjashme që lidhet me këtë proces?

5. Si e klasifikoni detyrën tuaj (cili është aktiviteti i juaj ditorë) në institucionin ku jeni të angazhuar?
 - Mësimdhënës i/e rregullt me orar të plotë 1
 - Mësimdhënës i/e rregullt me orar të pjesshëm 2
 - Mësimdhënës i/e rregullt me punë në disa institucione (në institucione të ndryshme me orare të ndryshme, duke ofruar shërbimin e njëjtë) 3
 - Mësimdhënës (zëvendësues) afat gjatë/mesëm 4
 - Mësimdhënës (asistentë) 5
 - Tjetër (ju lutem specifikoni) 6
6. A posedoni licencë speciale për ushtrimin e detyrës tuaj me nxënës me nevoja të veçanta, nëse po, cili autoritet e ka leshu licencën? Nëse jo, kalo në pyetjen e radhës.
 - _____

7. Sa kurse keni përfunduar në fushat e poshtëshënuara? (Rrumbullakos numri e kurseve për secilën kategori)

- | | |
|--|----------------|
| 1) Edukimi special për fëmijëri të hershme | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 2) Edukate elementare | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 3) Edukimi dygjuhësh | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 4) Edukimi special i përgjithshëm | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 5) Pamundësi për të mësuar..... | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 6) Prapambetja mendore..... | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 7) Dëmtime ortopedike..... | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 8) Çrregullim serioz emocional | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 9) Shurdhim dhe dëgjim i dobët | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 10) Verbëria dhe probleme me shikimi | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 11) Çrregullimet e komunikimit..... | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 12) Psikologji shkollore..... | 0 1 2 3 4 5 6+ |
| 13) Menaxhimi i klasës | 0 1 2 3 4 5 6+ |

8. Cila nga kategoritë e listuar përshkruan më së miri pozicionin tuaj në shkollë?

- Mësimdhënës i arsimit special
- Konsulent i mësimdhënësve të arsimit special.....
- Mësimdhënës i arsimit të përgjithshëm.....
- Terapist profesionist.....
- Psikologu shkollor
- Ndihmësi i klasës së arsimit special

9. Gjatë vitit akademik, ku keni punuar me nxënësit me nevoja të veçanta?

- Në klasë për edukim të përgjithshëm
- Në klasë për edukim special.....
- Në hapësira jo klasore (zyre apo të ngjashme).....
- gjaTjetër (specifiko).....
- Nuk punoj drejtpërdrejtë me nxënës me nevoja të veçanta

10. Gjatë vitit akademik, me sa fëmijë me nevoja të veçanta keni punuar (mesatarisht gjatë një jave)?

- 1-5
- 6-10
- 11-20
- Më shumë se 20

11. Cila është aftësia (kyçe) e kufizuar e nxënësve me të cilët jeni apo keni punuar?

- Paaftësia e të mësuarit
- Çrregullim serioz emocional
- Çrregullim i të folurit (gjuhës)
- Prapambetja mendore
- Verbëri apo shikim të dobët
- Shurdhë-memec
- Çrregullim fizik
- Vonesa në zhvillim
- Autizëm.....
- Lëndimi traumatik i trurit

12. Cila nga programet për edukim special përshinë më së miri objektiven e institucionit ku jeni i angazhuar?

- Akademia
 - i. Leximi.....
 - ii. Matematika
 - iii. Arti.....

- Të folurit dhe gjuha
 - i. Përpunimi dëgjimorë 4
 - ii. Të kuptuarit 5
 - iii. Të shprehurit 6
 - iv. Artikulimi i zërit/fjalës 7
 - v. Pragmatika gjuhësore 8
 - Socializimi
 - i. Socializimi 9
 - ii. Komunikimi masiv 10
 - iii. Vendbanimi 11
 - Aftësimi jetësor
 - i. Adaptimi 12
 - ii. Pavarësimi 13
 - Të tjera
 - i. Specifiko 14
13. Përafërsisht sa orë në javë edukim special i drejtpërdrejtë dhe shërbimeve të lidhura me të (domethënë, shërbimi i ofruar direkt fëmijës, nga mësimmshënësi apo specializant i një fushe të caktuar) është e planifikuar të i ofrohet nxënësve gjatë vitit shkollor?
-
14. Përafërsisht sa (në përqindje) e orëve totale në shkollë nxënësve me nevoja të veçanta iu ofrohet arsim special dhe shërbime të lidhura me to jashtë klasë së arsimit të përgjithshëm, por brenda mjedisit shkollor?
- Përqindja 0 1
 - Përqindja 1-10 2
 - Përqindja 11-25 3
 - Përqindja 26-50 4
 - Përqindja 51-75 5
 - Përqindja 76-99 6
 - Përqindja 100 7
15. Çfarë praktika dhe metoda shfrytëzohen?
- | | Përgjigjuni në secilën kategori..... | PO | JO |
|--|--------------------------------------|----|----|
| a) Udhëzim një për një | 0 | 1 | 1 |
| b) Udhëzime të grupeve të vogla | 0 | 1 | 1 |
| c) Udhëzime të grupeve të mëdha | 0 | 1 | 1 |
| d) Udhëzime të bazuara në kompjuter | 0 | 1 | 1 |
| e) Udhëzime të drejtpërdrejta | 0 | 1 | 1 |
| f) Vetë-menaxhim menaxhimi i sjelljes | 0 | 1 | 1 |
| g) Pa udhëzime speciale | 0 | 1 | 1 |
| h) Punë përmes kompjuterit me udhëzime | 0 | 1 | 1 |
| i) Punë përmes mjeteve tjera teknologjike..... | 0 | 1 | 1 |
16. A janë dedikuar kompjuter adekuat nxënësve me nevoja të veçanta?
- PO 0
 - JO 1
17. Sa i suksesshëm është programi për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionin ku jeni i/e angazhuar?
- 76-100 % 1
 - 51-75 % 2
 - 26-50% 3
 - 1-25% 4
 - 0% 5

18. Cila nga të kategoritë e listuar përshkruan më së miri qasjen e institucionit në procesin e edukimit special? Rrumbullakos përgjigjen për secilën kategori.

Në hapësira të rregullta mësimore	Në hapësira të dedikuara për edukim special
-----------------------------------	---

- a) Materialet e mësimit të përgjithshëm janë shfrytëzuar..... 0 1
- b) Disa ndryshime të vogla janë aplikuar 0 1
- c) Ndryshime substanciale janë aplikuar 0 1
- d) Janë shfrytëzuar materiale specifike të dizajnuara 0 1
19. Përafërsisht sa shpesh keni komunikuar me prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta gjatë vitit shkollor për programin ose përparimin e tyre.
- Çdo ditë ose disa ditë gjatë javës 1
 - Një herë në javë 2
 - Një herë në muaj 3
 - Disa herë gjatë vitit akademik 4
 - Një herë gjatë këtij viti akademik 5
 - Asnjëherë gjatë këtij viti akademik 6
20. Si mendoni që mund të forcohet ndihma për kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta?
- Duke pajisur institucionin me Teknologji Informative (TI) 1
 - Duke pajisur institucionin dhe nxënësit me TI 2
 - Duke zgjeruar kapacitetin e mësimdhënësve të specializuar 3
 - Duke krijuar hapësira të veçanta për trajtim special 4
21. Çka mendoni që duhet të ndryshohet për të ngritë një çështje aq të ndjeshme?
- Të përfshihen në trajnime speciale të gjithë mësimdhënësit 1
 - Të adaptohen hapësirat e përgjithshme klasore për integrimin nxënësve me aftësi të kufizuara më lehtë 2
 - Të zhvillohen platforma që mbështetin sistemin për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta 3
 - Të ndërtohen struktura paralele për trajtim special 4
22. Si mendoni ju që do të ndihmonit një proces të tillë?
- Me përkushtim të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta 1
 - Me dedikim të njëjtë për të gjithë nxënësit pa dallime 2
 - Duke i ndarë nxënësit në grupe sipas aftësive individuale 3
 - Duke u specializuar për trajtim të nxënësve me nevoja të veçanta 4
23. A mendoni që teknologjia informative do të ndikonte pozitivisht në arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta?
- Po 1
 - Jo 2
 - Nuk e di 3
24. Si njeheni kur punoni me nxënësit që kanë aftësi të kufizuara dhe kërkojnë ndihmë nga ju?
- Ndihem i privilegjuar që kam mundësi të ndihmoj 1
 - Ndihem i mangët dhe emocionalisht i thyer 2
 - Ndihem i brishtë sepse nuk po arrij të jap aq sa ju nevojitet 3
 - Nuk kam punuar asnjëherë me kategori të tillë 4
25. A mendoni që kontributi i juaj në punën me nxënës me nevoja të veçanta do të ishte më i mirë, nëse?
- Institucioni ku jeni i/e angazhuar do të krijonte hapësira të veçanta për trajtimin e punës dhe dedikimit ndaj nxënësve me nevoja të veçanta 1
 - Institucioni ku jeni i/e angazhuar ofron tretman special në hapësira të përgjithshme klasore ose të tjera 2
 - Institucioni ku jeni i/e angazhuar do të shfrytëzonte TI për arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta 3
 - Institucioni ku jeni i/e angazhuar ofron kurse speciale për mësimdhënës për trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta 4